



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 SHTATOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. SEPTEMBRA 2012. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartimore,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izvršnoj proceduri,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Agenciju za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o vodama Kosova,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o parničkom postupku
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o organskoj poljoprivredi
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o poljoprivredi i razvoju sela.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 58 deputetë, kështu që mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Në emër të grupit parlamentar, 5 minuta në emër të deputetëve, 3 minuta. Siç e dini, replika s'ka, por edhe mos i nxitni ato.

Fillojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar.

Të nderuar kolege deputete dhe kolegë deputetë,

Pas heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë është një kohë kur duhet të konceptohet si momentum për institucionet tona në përgjithësi dhe veçanërisht për Qeverinë, e cila duhet të bëjë ndryshime në formë dhe në përmbajtje.

Kur dëgjohet kjo ide, është e pakëndshme për qeveritarët dhe rrethet e tyre nga më të ndryshmet, për motive shpirtërore dhe materiale, por të gjithë duhet të vetëdijesohemi, se mbi gjithçka është ky vend dhe populli ynë i shumëvuahtur, që kërkojnë një ndryshim të tillë. Kjo nuk duhet të ndodhë për shkak të inercionit dhe pa koncept të studiuar për çdo dikaster të Qeverisë, se si ka funksionuar dhe për teorinë e ndryshimit të qeverisjes, se çka duhet ndryshuar. Pa një ekspertizë të mirëfilltë dhe të gjithanshme, më mirë të mos ndodh fare. Nuk duhet të digjet momenti dhe të mos ezaurohet koncepti i ndryshimit.

Është në përgjegjësi të lidërshit të PDK-së të analizojë, të vlerësojë dhe të vendosë për gjithë spektrin e ndryshimeve, duke pasur në konsideratë sugjerimet nga jashtë saj. Por, vendimi për ndryshimin e politikave qeverisëse nuk guxon t'ua lejë vullneteve, sado dashamirëse, të qendrave jashtë PDK-së, as zërave të oponencës, të cilat nuk kanë motiv ndryshimin për perfeksion, por krijimin e anarkisë. Është fat i mirë për këtë vend dhe për këtë popull, që PDK-ja ka shumë galeri minierash me kuadro të përgatitura dhe me eksperiencë, me përgjegjshmëri të pakontestueshme e me rrezatim lidërshi të dëshmuar në rrugën e deritashme maratonë.

Duke i konsoliduar në vazhdimësi formimet e tyre me mjaftë integritet, brenda dhe jashtë vendit, ju duhet vetëm krijimi i hapësirave, për të dhënë atë që i duhet momentit. Telegrafikisht, bëra një përshkrim për të thimthuar motivin te lidërshi, si aktorët

kryesorë, që duhet të pranojnë se është një momentum i rëndësishëm dhe historik për këtë vend, për institucionet e tij dhe për këtë popull, se duhet të ndryshojnë politikat qeverisëse të brendshme dhe të jashtme, doemos. Këtë e bëra edhe për opinionin tonë kureshtar dhe lojal ndaj të cilit duhet të jemi më të përgjegjshëm dhe më të përkushtuar se deri tani.

Çdo qeverisje ka nevojë për freskim në formë dhe në përmbajtje në një periudhë të caktuar. Kjo jona, duke pasur dhe sfida të veçanta, që nuk i ka çdo qeveri, veçanërisht pa dashur, imponohen ndryshime të shpejta për marrëdhënie të brendshme dhe për të ndryshuar në marrëdhënie ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, ndoshta në emër të vet, Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Në emër tim. I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Kur në qershor të këtij viti, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, mori vendimin për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për 8,9%, ndërsa KEK-u nëpërmjet një komunikate shprehu zhgënjimin për një vendim të tillë, ishte e qartë se KEK-u shumë shpejt do të paraqesë kërkesë të re për ngritje të çmimit të rrymës.

Vërtet, në fillim të këtij muaji, përkundër krizës së madhe ekonomike, që e ka kapluar qytetarin e Kosovës, KEK-u i ka dorëzuar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë kërkesën për ngritje të re të çmimit të energjisë elektrike, për të cilën kërkesë duhet vendosur deri në mars të vitit 2013.

Pasur parasysh rritjen e çmimit të bukës, produkteve ushqimore, pastaj të druve dhe lëndëve tjera djegëse, një rritje eventuale e re e çmimit të rrymës do të ishte një barrë e rëndë dhe gati e papërballueshme për qytetarët e Kosovës, 50% të cilëve edhe ashtu janë të papunë, kurse 18% jetojnë në varfëri të skajshme. Njëherësh, çmimi i ri i energjisë do të nxisë shtrenjtim të çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë, e kjo do të varfërojë edhe më shumë konsumatorin kosovar, të cilit duke pasur parasysh papunësinë dhe mos ngritjen e pagave, në vazhdimësi po i dobësohet fuqia blerëse.

Andaj, me qëllim të ruajtjes së standardit edhe ashtu seriozisht të dëmtuar të qytetarit kosovar, kërkoj nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, që mos të aprovojë kurrfarë rritjeje të re të çmimit të rrymës, sepse kërkesa e KEK-ut nuk pasqyron koston reale të prodhimit të energjisë elektrike, ngase sipas raporteve zyrtare shihet se humbjet në sistemin energjetik, për të cilin është përgjegjës pikërisht KEK-u, shkojnë deri në 38%, ndërsa vetëm në Distribucion janë 17%. Në shtetet ku sistemi energjetik menaxhohet mirë, këto humbje janë vetëm 3-4%, kurse rritja eventuale e çmimit të rrymës do të ishte pasojë e paaftësisë së kësaj Qeverie për ta revitalizuar këtë sektor tejet strategjik të vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në fillim të këtij muaji të burgosurit e Burgut të Dubravës u hodhën sërish në grevë. Qëllimi i kësaj greve ishte shumë i thjeshtë dhe shumë i qartë, futja e amnistisë si kategori kushtetuese. Kjo është greva e tretë me radhë gjatë mandatit të kësaj Qeverie, për të njëjtin qëllim dhe sikur rastet e mëhershme edhe kjo grevë përfundon pa rezultat konkret.

Ajo çfarë arritën të burgosurit në këtë grevë ishte demaskimi, se kjo nuk është një Ministri e Drejtësisë, por Ministri e premtimeve të kota, Ministri e mashtrimeve dhe mbi të gjitha ministri e padrejtësisë.

Deklaratat në vazhdimësi të ministrit të Drejtësisë, se gjoja ia paska dërguar propozimin Komisionit për Ndryshime Kushtetuese, janë një mashtrim i radhës të burgosurve, pasi që ministri i Drejtësisë është i vetëdijshtë për mandatin dhe përgjegjësitë që kishte Komisioni Kushtetues, andaj edhe deklaratat e tij janë një hedhje hi syve të burgosurve.

Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh amnistinë si institut, mirëpo ka vende të cilat nuk e kanë të rregulluar amnistinë me Kushtetutë, porse e kanë të rregulluar me Ligjin për amnisti, siç janë në këtë rast: Maqedonia e Bullgaria. Ne konsiderojmë që amnistia është një institut i së drejtës romake, tradicional dhe shumë demokratik dhe rrallë gjenden shtete të cilat nuk e kanë, madje, amnistinë e kanë të parapara edhe legjislacionet e vendeve më diktatoriale dhe me nivele shumë të ulëta të zhvillimit të demokracisë.

Për vite me radhë të burgosurit kanë qenë të mashtruar nga Ministria e Drejtësisë. Më e keqja e kësaj është, se përveç që nuk ka filluar së hartuari Ligji për amnistinë, kjo ministri e ka hequr këtë edhe nga Projektkodi Penal. Kësisoj, Ligji për amnistinë është edhe një e drejtë e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe edhe ne si shtet duhet ta kemi atë.

Ajo çfarë ka rëndësi është që me një ligj të tillë për amnistinë të rregullohen detajisht të gjitha procedurat dhe kushtet për amnistinë e të burgosurve, me qëllim që të pamundësohet keqpërdorimi i këtij ligji, siç ka ndodhur edhe te rasti i faljes.

Përfundimisht, konsideroj se Ministria e Drejtësisë, me aktin e dhënies së tërheqjes dhe me revokimin e saj e ka arritur kuotën më të lartë të jo moralit si rezultat i dhënies së ideve dhe premtimeve të tij të mos kthyer kurrë në normë juridike.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani poslanici,

U prethodnim danima poslanici Samostalne Liberalne Stranke su u više navrata pokazali da su pravi predstavnici svog naroda i pravi partneri Vlade. I pored negativnih pojedinih odluka, koje su se nametnule a koje su srpski poslanici izglasali i na taj način još jednom dokazali da su odgovorni i kao ljudi i kao poslanici u ovom Parlamentu.

Našu zabrinutost i naše strahove, na koje upozoravamo svakodnevno, ili na svakoj plenarnoj sednici neki poslanici to vide kao zlu nameru. Moram reći da i pojedini ministri nemaju dovoljno sluha za probleme s kojima se srpska zajednica sada susreće i na koje ih upozoravamo. To kažem iz razloga zato što se ništa nije preduzelo da se srpsko stanovništvo zaštiti od sve češćih napada.

Poštovana gospodo poslanici, i pored upozorenja da se zločini i zločinci ne razotkrivaju, da imamo napade koji su etnički motivisani i da je do sada bezbednost narušena puškom ili nekim drugim oružjem, sada imamo oružje koje je još opasnije, a to je novinarsko pero.

U prethodnim nedeljama svedoci smo da je list „Zeri“ u svom tekstu okarakterisao nevladinu organizaciju Centar za Mir i Toleranciju, kao mesto gde se sakupljaju srpski špijuni. I na taj način doveo u opasnost starce i starice iz Prištine, koji dolaze da potraže neophodnu medicinsku pomoć. Ovo govorim upravo iz razloga zato što je MUP u prethodnom periodu u više navrata hteo da zauzme te prostorije i da iseli Centar za Mir i Toleranciju.

Sada se postavlja pitanje, dali je članak koji je izašao u listu nije slučajan, već da i on ima svoj cilj. A to je da pošto poto iseli korisnik prostorija, ne misleći pri tom koje posledice to može da ima.

Da ovo ne govorim iz nekog razloga, koji bi se pogrešno protumačio, da srpski poslanici govore nešto samo da bi nešto rekli, upotpunjujem svojom izjavom za novine, portparolu Kosovske Policije za region Gnjilana, Ismet Hašani, kada se pucalo u šumu na šestoricu srba, a njegova izjava je glasi: „... da Policija nije izašla na lice mesta, jer je bila malo daleko“.

Gospodo poslanici, ovakve neizbalansirane izjave, kao i loši rezultati Policije bacaju loše svetlo i negiraju misiju i ciljeve Kosovske Policije, a građanima srpske zajednice povećavaju sumnju u potpunu integraciju u Kosovsko društvo. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është libri shkollor i historisë i klasës së pestë, të cilin e mora ta shfletoj derisa vajza ime për herë të parë po e lexonte. Më tërhoqi kureshtja ta lexoj këtë libër të tërin, për të parë se çfarë po u mësohet fëmijëve tanë në librin shkollor të historisë. Dhe, mbeta i shokuar me atë se çfarë u është ofruar dhe çfarë u është mohuar fëmijëve tanë të mësojnë nga libri shkollor i historisë i klasës së pestë.

Në këtë libër shkollor të historisë fëmijëve tanë u mohohet historia e vërtetë. Ata mund t'i mësojnë disa përralla të shkruara keq nga Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj, por nuk

mund të mësojnë për historinë e vërtetë të popullit tonë, për historinë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë libër shkollor lëre që nuk flitet për themelimin dhe historinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por fëmijëve tanë u mohohet të mësojnë edhe për komandantin legjendar Adem Jashari, i cili paraqitet në këtë libër vetëm me një foto. U mohohet të mësojnë edhe për heronjtë tjerë: si Zahir Pajaziti, Luan e Shkëlzen Haradinaj, për Fehmi e Xhevë Lladrovcin, për Ilaz Kodrën e shumë e shumë heronj të tjerë. Fëmijëve tanë në këtë libër shkollor u mohohet të mësojnë për historinë e vërtetë, për heronjtë dhe figurat më të ndritura të kombit tonë, që dhanë më së shumti, që këta fëmijë të rriten dhe të shkollohen të lirë.

Të nderuar kolegë deputetë, besoni apo jo, në këtë libër të historisë, fëmijët tanë mund të lexojnë në faqen e 104-të vetëm tre rreshta për luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa në faqen 106, si për ironi mësojnë dy rreshta më shumë për administratën e UNMIK-ut dhe më pas mësojnë edhe për zgjedhjet e pasluftës dhe historinë e tyre.

Në këtë libër më shumë rëndësi i jepet hapësirë formimit të partive politike dhe krijimit të filmave si “Uka i Bjeshkëve të Nemuna” e “Era e Lisi” se sa formimit të UÇK-së dhe komandantit legjendar të saj. Në këtë libër të historisë fëmijët tanë nuk mund të mësojnë as për protestat e studentëve të 1 tetorit 1997, e as për Adem Demaçin e as për Ukshin Hotin e as që mund të gjesht një fjalë të vetme për mijëra të burgosur politikë, as edhe një fjalë, as edhe një numër për mijëra të vrarë e të zhdukur në luftën e fundit.

Të nderuar kolegë deputetë, ky nuk është libër i historisë. Kjo është një përrallë me data e shkruar keq nga Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj e i lejuar për botim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me vendim numër 99/01-B të datës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Muajve të fundit po kalojmë nëpër një periudhë, e cila ka herë nuk mbahet mend. Kam frikë se edhe pasojat e saj do të jenë mjaftë të rënda dhe të pa sanuara. E kam fjalën për thatësinë, por edhe për zjarret. Tashmë, është e qartë se humbëm mbi 3 400 hektarë me pyje, prej të cilëve rreth 1 000 hektarë pyje ekonomike. Mirëpo, ende nuk dimë se çfarë do të jenë pasojat nga thatësia. Sado që, ajo nuk godet shumë grurin dhe të mbjellat vjeshtore, të gjitha parashikimet tregojnë se rendimentet e kulturave pranverore do të jenë katastrofave, si të misrit, patatja, e tjera.

Edhe pse ende nuk kemi ndonjë shifër të përafërt, së paku rreth parashikimeve për rendimentet që do t'i vjelim nga këto kultura, fermerët janë tejtejt të shqetësuar.

Ngushëllimi për këtë gjendje, padyshim se do të gjendet në konstatimin, se kjo është një dukuri natyrore dhe se me thatësinë dhe me pasojat e sajë në bujqësi po ballafaqohen edhe shumë shtete më të fuqishme dhe më të organizuara se Kosova. Por, kjo do të shërbejë vetëm për ta mbuluar mospunën dhe papërgjegjësinë e institucioneve përgjegjëse përballë kësaj situatë.

Qeveria e Kosovës duhet të japë përgjigje se a ka bërë mjaft për zbutjen e pasojave në bujqësi.

Unë me përgjegjësi të plotë them, se nuk ka bërë atë që ka pasur mundësi. Ajo asnjëherë nuk është marrë me këtë problem, madje as që ka paraparë mundësinë se edhe Kosova mund të goditet nga thatësia, e cila pas do të lërë pasojë në shumë hallka të punës dhe të jetës. Më saktësisht, Qeveria e Kosovës nuk ka bërë asnjë përpjekje për shfrytëzimin e mundësive për zgjerimin e sipërfaqeve me mundësi për ujitje. Për fat të keq, në këtë rrafsh gjendja është edhe më e keqe se që ishte para vitit 1990. Tash ka mundësi të ujitjen 40 000 hektarë ose 10 000 hektarë më pak se para më shumë se dy dekadave. Kjo ka ndodhur për shkak se është shkatërruar një potencial i konsiderueshëm i infrastrukturës dhe i stabilimenteve për ujitje, derisa ka munguar përpjekjet për sanimin e tyre. Mund të thuhet se sipërfaqet me mundësi për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes janë zvogëluar edhe për shkak të ndryshimit të destinacionit të tokës apo ndryshimit të kulturave bujqësore, por ndikimi i tyre është shumë i vogël.

Po të kishte punuar më shumë Qeveria e Kosovës në këtë drejtim, padyshim se pasojat nga thatësia do të ishin shumë më të vogla. Posaçërisht, kur kemi parasysh se sipas disa hulumtimeve, madje edhe të dhënave të disa agjencive qeveritare, Kosova ka kapacitet ujqor për ujitjen e mbi 140 000 hektarëve, sado që kjo shifër mund të duket imagjinare, por megjithatë kjo tregon se ka mundësi reale për shtrirjen më të madhe të stabilimenteve për ujitje.

Unë përshëndes faktin se po rriten sipërfaqet që mund të ujitjen, por kjo nuk është as për s' afërmi me nevojat që ka bujqësia dhe mundësitë që janë. Për këtë nuk mjaftojnë vetëm resurset ujore që ka vendi, por një qasje më serioze e Qeverisë për shfrytëzimin e tyre dhe më shumë investime, e më pak në asfalt.

Ndërkaq, në fund, po përmendi se pasojat nuk do të duken vetëm tek rendimentet e mbjelljeve pranverore, por nëse vazhdojnë këto....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vesna Nikiq.

VESNA NIKIĆ: Gospodine predsjedniče, verujte mi da danas nisam imala nameru da govorim, ali osećam potrebu da vam pojasnim komentar, koji ste uputili prošle nedelje na račun mog izlaganja.

Ovo nije replika, da kažem odmah na početku, jer za repliku se smatra jedino ako se zatraži u toku jedne sednice. Ovo je druga sednica, tako da mogu slobodno da pojasnim.

Meni, gospodine, nisu potrebne nikakve, niti bilo čije naočare da sagledam realnost u kojoj se nalazi srpska zajednica svih ovih godina. Na moju veliku sreću a vašu žalost, ne pripadam ni onoj grupici srba unutra SLS-a, koji moraju da slušaju vaša naređenja i kojima je jedino dozvoljeno da gledaju kroz prizmu vaših naočara. Ja ponosno, sa ovog mesta, mogu da istaknem da sam već 22 godine član Srpskog Pokreta Obnove, stranka koja zastupa jednu modernu, zdravu, proevropsku politiku, politiku koja se bazira na zdravim osnovama, koja pruža šansu za sve etničke zajednice, politiku, koja želi da poboljša život svih ljudi dostojnog civilizovanog čoveka u 21-om veku.

No, mi jesmo u 21-om veku, to jeste primetili, ali položaj u kojem se nalazi srpska zajednica i uslove koje uživa jesu daleko, verovatno iz nekog 18-og veka. Takav katastrofalan primer je upravo gospodin Marinković naveo u kakvom se položaju nalazi srpska zajednica i na koji način se tretira i ovaj mnogo je takvih primera a kao jedan ću uzeti i transkripte, koje dobijamo sa svake prethodne sednice.

Ako obratimo pažnju, ti transkripti se daju u izvornom obliku, tako da sam uskraćena za pravo, ukoliko ne prisustvujem nekoj od sednica, da saznam šta su kolege iz albanske zajednice govorili. A to je, kako znate, kršenje zakona o jeziku, odnosno primeni jezika. A znamo da je srpski jezik zvanični jezik na Kosovu a da time gospodo kršite i svoj Ustav.

Mnogo je takvih primera a da ne mogu a da ne pomenem primer o strahovitom institucionalnom terroru nad srpskim narodom kada su u pitanju tablice i dozvole, gde se na jedan bespravan način oduzimaju i dozvole i tablice, iako se ne nalaze na automobilu. A samo ću da podsetim da se vozačka dozvola nigde u svetu ne oduzima na takav način i da je ova dozvola koju vi u samome startu, bez ikakve provere nazivate falsifikatom, važeća u celoj Evropi. Tako da posle isteka od godinu dana, ukoliko se kod lice zatekne ta dozvola, može samo da se novčano kazni. A ovde se oduzima. Prosto mi se nameće pitanje - Zašto oduzimate dokumenta, koja su po vama nevažeća? Jedino ako vas trese nostalgija za srpskim dokumentima pa želite da ih sačuvate kao uspomenu.

No gospodo, sasvim sam sigurna i ne mogu da vam ovaj zamerim toliko angažovanje oko promovisanja standarda, koji nisu vidljivi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, e ke ndërruar pak dioptrinë. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet Qeveritar,

Fillimisht, krejt shkurt rreth arrestimit të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, zotit Sami Hamiti dhe mungesës së reagimit nga Lidhja Demokratike, qytetarët janë

jashtëzakonisht të shqetësuar për lejet që i kanë marrë, banesat që i kanë fituar dhe a është kjo gjithmonë e lidhur me krim të organizuar dhe a do të vazhdojnë ato leje t'i kenë.

(Ndërhyrje)

Mirëpo, kjo ishte vetëm për fillim. Do ta vazhdoj dhe më tutje temën për çmimet e naftës. Keni rastin, mund të flisni. Do ta vazhdoj temën për çmimet e naftës. Ka pasur reagime të Shoqatës së natarëve, do të doja që t'i përgjigjesha atyre.

Çmimi i naftës në prill të këtij viti, duke iu shtuar edhe taksat, ka qenë 1 euro e 27 centë, ndërsa në pompat e benzinës ka qenë 1 euro e 30 centë, maksimumi. Tash, bashkë me taksat, çmimi i naftës shkon 1 euro e 10 centë- 11centë, ndërsa shitet 1 euro e 37 centë, 38 centë deri në 1 euro e 40 centë. Pompat e benzinës në Kosovë, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, i fitojnë plotë 30 centë nga një litër e benzinës apo naftës, ndërsa në shtetet e Bashkimit Evropian, për shembull në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për galon, që është 4 litra fitohen 16 centë. Pra, në litër fiton pompa e benzinës 4-5 centë nga litra. Këtu do të duhej të ndërhynte Ministria e Tregtisë e Industrisë, që ta bëjë rregullimin e tregut apo derregullimin e tregut, i cili për momentin është kaotik.

Një çështje tjetër është edhe cilësia e naftës, që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe inspektorët e kësaj ministrie, nuk po shkojnë ta kontrollojnë cilësinë e naftës, ashtu siç duhet. Sipas informatave, që unë i kam, para se inspektorët të mbërrijnë në pompa të benzinës, pronarët e pompave të benzinës janë të informuar që ata do të shkojnë atje. Pra, këtu ka shumë punë për t'u bërë dhe unë qëndroj prapa asaj që kjo është vetëm një strukturë mafioze dhe kriminale, që po e eksploaton jashtëzakonisht shumë qytetarin e Kosovës, sepse të gjitha çmimet tjera edhe çmimi i bukës dhe çmimet tjera janë të varura nga kualiteti dhe nga çmimi i naftës. Faleminderit!

KRYETARI: Po, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është interesant se ky njeri që pak më herët foli, s'u mësua kurrë t' i këqyrë punët e veta, bizneset e veta...

(Ndërhyn Berat Buzhala: I këqyri unë të miat...)

...edhe mos të mundohet ta mësojë Lidhjen Demokratike çfarë duhet të bëjë. Ne e kemi thënë vazhdimisht, ne jemi që në këtë vend të sundojë ligji. Zoti Hamiti është kryesues i Kuvendit, është marrë në bisedë dhe ne presim dhe besojmë se ai do të lirohet, por është punë e gjyqësisë. Besojmë, aq më shumë nga ato pretekstet që u thanë.

Por, zoti kryetar, unë e di që e keni vështirë t'i menaxhoni njerëzit që s'e menaxhojnë veten, por sinjorisht po e them, nuk duhet keqpërdorur kjo foltore. Asnjëherë Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka dalë t'i tregojë këtij zotëriut se sa kryetarë komunash i ka nën hetime, sa personalitete tjera, sepse i kemi thënë që këto janë punë të Gjykatës dhe të

drejtësisë. Dhe, mos të tentojë ky tash, njëfarë, të mos them, balancimi ta bëjë edhe për hetimet që bëhen ndaj kujtdo qoftë.

Ne jemi fytyra publike, jemi njerëz publik, është shumë normale edhe të hetohemi, por argumentet duhet t'ua lëmë drejtësisë, prokurorisë dhe të mos tentojmë të bëjmë spektakle. E këtë e thashë sa për ta thënë në fillim, nuk është kjo vetëm sa për ta thënë siç e tha, por nuk është mirë të keqpërdorët kjo foltore dhe LDK-ja ka qenë, është dhe do të jetë për sundim të ligjit. Të mos paragjykojmë për njerëz, nuk kemi paragjykuar edhe për ata që kanë bërë miliona e miliona e vërtet, kanë qenë raste sociale dhe dihen, kjo Kosovë është e vogël, dihen për të gjithë këta njerëz. Por, duhet t'ua lëmë organeve të drejtësisë ta bëjnë punën e vet. Të mos përzihen ata që s'marrin vesh. Të mos bëhen argat i drejt me këto gazeta, s'po e them të tashme, dikush që e ka kryer këtë punë edhe vazhdon ta kryejë, të fillojë të na tregoj se sa janë të shqetësuar qytetarët e Prishtinës, qytetarët e Kosovës, që janë të shqetësuar për të gjitha këto që po ndodhin në Kosovë.

Po, këtu duhet të sundojë ligji, dhe jo politika ta marrë punën në dorë. dhe, jo të infiltrohet, jo për t'i futur hundët, më falni në shprehje, edhe ata që s'duhet t'i fusin në këto punë. Ne kërkojmë nga organet e drejtësisë të veprojnë ndaj të gjithëve që nuk punojnë mirë, ose që punojnë në kundërshtim me ligjin. Por, t'ia lëmë organeve të drejtësisë dhe të mos paragjykojmë. Njeriu është marrë që disa orë në pyetje dhe presim dhe, LDK-ja do ta thotë qëndrimin e saj për çdo gjë. Por, mos të tentojmë të bëjmë tash spektakle këtu, të thirren edhe njëherë po them, ata të cilët deri dje me byrekë kanë jetuar. E ka plot të tjerë që jetojnë me byrekë, po e them shumë kësisoj, e tash kanë bërë miliona. Dhe, prandaj kemi thënë është ministri i Drejtësisë këtu, konfiskimi i pasurisë, ligji që është drejtuar duhet t'i marrë krejt parasysh edhe ata që deri dje s'kanë pasur gjë para shpirti, siç thuhet dhe jo t'i legjitimojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputete dhe deputetë,

Se shteti mund të promovohet nëpërmjet resurseve artistike e kulturore, qofshin ato edhe nëpërmjet individëve, u pa gjatë fundjavës që e lamë pas.

Këngëtarja më sensacionale sot, në botë, Rita Ora, kishte zgjedhur pikërisht vendin e saj të lindjes për të xhiruar klipin e ri. Në prani të mijëra qytetarëve e mbështjell me flamurin shtetëror, ajo u ngrit në Obeliskun e Pavarësisë, duke dëshmuar kështu edhe kujdesin ndaj popullit, por edhe ndaj shtetit të saj. E mediet më prestigjioze nuk lanë pa e komentuar rikthimin e saj në vendin e lindjes.

Rita, i bëri nder Kosovës në fushën e diplomacisë publike. Dhe, me plot të drejtë ajo mund të quhet ambasadore nderi e Kosovës, siç mund të quhen dhe të emërohen edhe shumë artistë, sportistë me famë botërore, të cilët vend të origjinës e kanë Kosovën.

Me këtë titull, Qeveria shqiptare kishte dekoruar më parë edhe aktoren Eliza Dushku. Kosova, më shumë se kurrë ka nevojë për përmirësim të imazhit dhe forcim të subjektivitetit të saj ndërkombëtar. E kur jemi këtu është për t'u vlerësuar edhe emërimi i shtatë konsujve të nderit nga Ministria e Punëve të Jashtme, kurse në proces të emërimit janë edhe disa të tjerë, nëpërmjet të cilëve po synohet të arrihet edhe përmirësimi i imazhit në terren, në fusha të ndryshme e që padyshim se kjo përbënë një hap para në diplomacinë publike. Një hap të tillë, pa dyshim se duhet ta ndjekë edhe Presidenca në emërimin e ambasadorëve të nderit.

Të nderuar kolegë deputetë, kultura dhe arti kanë një ndikim universal në të ardhmen e popujve. Kjo u bë e qartë menjëherë pas përfundimit të mbikëqyrjes së Pavarësisë së Kosovës, me ç'rast ministri i Jashtëm, zoti Hoxhaj, nënshkroi dy marrëveshje të rëndësishme, njërën me Japoninë e që ofron mbështetje të fuqishme për Orkestrën e Filarmonisë së Kosovës dhe tjetrën me Gjermaninë, e cila ofron po ashtu, shkëmbime akademike në kinematografi, në media dhe arsim. E kjo marrëveshje e tillë përbën një hap të rëndësishëm në marrëdhëniet kontraktuale gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë.

Kapitulli i ri për Kosovën apo përfundimi i pavarësisë së mbikëqyrtur nuk i jep fund edhe interesimit të shteteve mike, por, siç po shihet, këto shtete po ofrojnë përvojat e tyre dhe shkëmbimin e përvojave me Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar! Shpresoj se nuk do ta zgjas më shumë se dy minuta.

Çështja që unë ngre lidhet me, tash kaloi euforia e festimit të përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare, një moment historik, po ndoshta kur të kalojë euforia, duhet parë si ne e festuam. A e festuam në mënyrë dinjitoze, a na funksionoi protokolli shtetëror? Dhe, menjëherë mund të them se protokolli shtetëror lë shumë për të dëshiruar.

Nuk do të ndalem në episode tjera, por do të koncentrohem vetëm në një konferencë, që u mbajt, ku patëm shumë personalitete dhe rrallë në Kosovë do të kemi kaq shumë personalitete që kanë kontribuar në shtet krijim. Por, fatkeqësisht, pak kishte personalitete vendore, pak kishte përfaqësues të partive politike, pak kishte përfaqësues të Parlamentit, pak kishte njerëz, që jo më pak se dy dekada kanë punuar në shtet-krijim. Dhe, në një mënyrë ne u ndiem keq, sepse aty pamë miq tanë që na thërrisnin në telefon dhe na thoshin, ku jeni dhe ne nuk mund të arsyetoheshim se nuk kemi ftesë askush nga Parlamenti. Në anën tjetër, aty pamë parakalimet e njerëzve, që ishin jashtëzakonisht të rinj në kohën, kur disa prej neve, duke filluar nga ju kryetar i Kuvendit, bënim hapa titanik në krijimin e shtetit dy dekada më parë. Dhe, mendoj se ne duhet të mësohemi që festat siç është kjo t'i festojmë në mënyrë dinjitoze. Shtet krijimi është vepër e përbashkët. Shtet-krijimi është një e arritur, që na ka bashkuar gjithmonë. Dhe, unë uroj që protokolli ynë shtetëror të ketë parasysh se Kosova në aktivitete të tilla, të përfaqësohet në mënyrë shumë të dinjitetshme, sepse vetëm kur përfaqësimi ynë është i

dinjitetshëm, atëherë edhe performansa e shtetit tonë të ri do të jetë shumë më e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: E përfunduam këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar gjashtë pyetje parlamentare. Po fillojmë me pyetjen e parë. Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri s'është këtu. Mund ta bësh pyetjen, nëse do natyrisht.

AFRIM KASOLLI: Jo, faleminderit, kryetar! Kjo pyetje ka mbetur nga java e kaluar. Unë ia kam bërë javën e kaluar kryeministrit, Po e përsëris edhe sot pyetjen. Në emisionin “Target” të RTK-së, të 25 marsit 2012, keni deklaruar se e keni përmendur në bisedime me Serbinë, në Bruksel, Luginën e Preshevës.

Pyetja parlamentare ka qenë, pra kur dhe si e keni përmendur dhe cili ka qenë rezultati i këtyre bisedimeve? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Ministri nuk është këtu, do ta bësh pyetjen? Vazhdojmë!

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministren Mimoza Kusari Lila. Ministrja nuk është këtu. Doni ta bëni pyetjen?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pra, siç e thatë ju, ministrja nuk qenka këtu. Është hera e dytë që nuk po vjen për të marrë pjesë në seancë për t'iu përgjigjur këtyre dy pyetjeve. Në fakt, unë i kam dy pyetje, të cilat lidhen me të njëjtën çështje. Të dyja po i lexoj tash, meqenëse është ky shansi e fundit, të them ashtu, që të marr përgjigje nga ministrja, e cila nuk është këtu.

Pyetjet e mia kanë të bëjnë me masën e mbrojtjes ose bllokimit të importimit të çimentos në Kosovë, gjë që e ka dëmtuar më së shumti importin e çimentos nga Shqipëria, meqenëse pjesa më e madhe e çimentos është importuar nga atje. Dhe, njëra prej pyetjeve ka qenë të kuptohet nga ministrja se cila është përqindja e tregut që e ka tash “Titanit”, si pasojë e mbrojtjes nga Qeveria dhe sa kanë rënë në përqindje importet nga Shqipëria si pasojë e masës së vendosur nga ministrja? Dhe, pyetja tjetër ka të bëjë me profitin e “Titanit”, pra sa milionë euro ka qenë profiti si rrjedhojë e mbrojtjes gjatë kohës sa ka qenë masa në fuqi? Pra, deri në ç'masë i është rritur profiti “Titanit” si pasojë e drejtpërdrejtë e mbrojtjes që i ka ofruar Qeveria e Kosovës kësaj kompanie? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për ministrin Fehmi Mujota. Deputete, e ke mundësinë ta parashtrosh pyetjen.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Në shumë fshatra nëpër Kosovë, aty ku janë shtruar rrugët me asfalt, pothuajse në të gjitha rastet mungojnë trotualet, mungon sinjalizimi, mungojnë shenjat për shpejtësinë e kufizuar, pengesat e ashtuquajtura “policë të shtrirë”.

Kjo ndodh posaçërisht afër shkollave dhe si pasojë po vazhdojnë për çdo ditë të ndodhin aksidente fatale. Në të shumtën e rasteve, janë fëmijë shkollorë. A keni filluar të ndërmerri diçka si ministri dhe nëse po, a mund të na tregoni çfarë veprimesh keni marrë në përmirësimin e kësaj gjendjeje?

KRYETARI: Ministër Mujota, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Kadaj,

Me të drejtë keni konstatuar se në Kosovë, përkatësisht në fshatrat e Kosovës janë shtruar shumë rrugë brenda këtyre viteve dhe Ministria e Infrastrukturës ka investuar mjete të konsiderueshme për këto investime publike, të cilat shkojnë në të mirë të jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe posaçërisht në ato vendbanime, në të cilat kanë ndodhur këto ndërtime.

Ministria e Infrastrukturës kryesisht i ka bërë ato investime në rrugët, të cilat kanë qenë prioritete të kuvendeve komunale dhe në përgjegjësinë e vet përfshin kryesisht pozicionon e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në këto rrugë që mban. Mirëpo, është e ditur se pas përfundimit të kontratave dhe pranimit teknik të secilës rrugë lokale që ka ndërtuar Ministria e Infrastrukturës, përgjegjësia për mirëmbajtjen mbetet në autoritetet lokale, përkatësisht te komunat. Meqenëse rrugët lokale janë kompetencë e komunave, por për mungesë të kapaciteteve buxhetore të komunave, Qeveria ka investuar në këto rrugë, natyrisht që edhe çështja e vendosjes së “policëve të shtrirë”, siç quhen në rrugë, mbetet çështje e përgjegjësisë së komunave dhe çështje e vlerësimit të tyre se ku duhet vendosur dhe ku jo.

Në rrugët nacionale dhe regjionale, Ministria e Infrastrukturës e ka programin e posaçëm vjetor për pajisjen e tyre, përkatësisht me sinjalizim horizontal dhe vertikal. Dhe, në këtë program, natyrisht bën pjesë vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në të gjitha rrugët magjistrale dhe rajonale, që nënkupton një gjatësi rreth 2 000 km.

Çështja e heqjes së tabelave në komunikacion është bërë një dukuri. Nuk mund të thuhet më që është fenomen, është një dukuri që po ndodh nga persona të pandërgjegjshëm që vazhdimisht po i dëmtojnë, e në raste të caktuara ato po i marrin për përfitime tejet të vogla personale, duke shkaktuar rrezik në rrugë, duke shkaktuar fatkeqësisht humbje të jetës së njerëzve.

Natyrisht që Ministria e Infrastrukturës për këtë gjendje i ka bërë të gjitha aktivitetet që duhet t'i bëjë ministria në kuadër të përgjegjësisë ligjore. Nëpërmjet Këshillit të Sigurisë Rrugore, në takimet e veta, i ka përcaktuar prioritetet dhe veprimet që duhen ndërmarrë brenda periudhës kohore për të cilën po flasim dhe periudhën kohore, e cila vjen. Në këtë aspekt, mund të konstatoj se Ministria e Infrastrukturës deri më tash ka ndërtuar 8 nënkalime, kryesisht në afërsi të shkollave dhe natyrisht edhe 12 trotuare, që nuk janë të mjaftueshme. Kërkesat janë në rritje nga komunat për ndërtimin e trotuareve dhe hapësirave të tilla, të cilat i sigurojnë nxënësit dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Duhet përmendur edhe faktin se në ndërtimin e trotuareve, kuvendet komunale ballafaqohen me pengesat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Pyetje shtesë, deputete?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ministër, ju e dhatë një përgjigje fort të përgjithësuar. Shumë konkretisht, Alisa Avdyli, nga fshati Metehi, është rasti i cili ka pësuar aksident fatal. Katër fëmijë kanë vdekur brenda një kohe shumë të shkurtër. Shumë konkretisht, bëhet fjalë për rrugë regjionale. A ke filluar ndërtimin e trotuareve në ato vend, apo jo? Nëse po, kur keni filluar dhe kur do të përfundojnë këto trotuare, sepse prindërit e këtyre fëmijëve kanë filluar t'i ndalin fëmijët nga shkolla për shkak të rrezikshmërisë tepër të lartë. E kjo s'ka të bëjë me komuna, ka të bëjë pikërisht me ju, sepse është rrugë regjionale.

Nëse keni filluar, ju lutem, shumë shkurt, na njoftoni për afatet kohore kur do të përfundojnë këto trotuare? Nëse jo, na dorëzoni me shkrim se kur do të filloni dhe cilat janë afatet kohore, sepse është rast shumë urgjent. Faleminderit!

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, e nderuara deputete, Pyetja juaj është adresuar kryesisht për çështje të fshatit, por meqë kaluam te çështjet e rrugëve regjionale, atëherë unë them që të gjitha pikat e zeza të cilat janë vërtetuar nga autoritetet përgjegjëse për këto çështje janë vendosur në prioritet për investime.

Në çështjet që kanë të bëjnë me projektet që e rrezikojnë jetën e fëmijëve nëpër fshatra, ne edhe tash u bëjmë ftesë kuvendeve komunale që nëse ato i vendosin në prioritet ato hapësira për ndërtim trotuaresh, ministria do t'i përkrahë me buxhet, në kuadër të buxhetit për bashkëfinancim. Ndërsa, në shumë raste ndikojnë shumë faktorë anësorë në fatkeqësitë në komunikacion, pa dashur ta arsyetoj ndonjërin rast, që është përgjegjësi e ministrisë, apo përgjegjësi e komunës. Kjo s'ka fare rëndësi. Humbja e një jete të njeriut është shumë, por për fat të mirë mund të themi se nëse krahasojmë statistikën nga viti 2010, 2011 dhe 2012 kemi një rënie të numrit të të vdekurve në komunikacion, por Ministria e Infrastrukturës në kuadër të projekteve të veta, sipas planit që ka, do t'i zhvillojë të gjitha ato projekte që i ka në realizim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, e ke edhe një pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Mund ta lexoni pyetjen.

DONIKË KADAJ-BUJUPI: I nderuari, kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me dështimet e diplomacisë kosovare, të cilat po e dëmtojnë vendin me skandalet e fundit me rastin e Malit. Mirëpo, duke marrë parasysh që ministri nuk është këtu, e as zëvendëskryeministri, pres që në seancën e radhës të jenë këtu dhe të na japin një përgjigje si Kuvend se çka po ndodh dhe a ka mbarim ky skandalizim i diplomacisë dhe marrëdhënieve me jashtë.

KRYETARI: Faleminderit! Pasi deputeti Liburn Aliu në ndërkohë erdhi, e ka mundësinë ta lexojë pyetjen.

LIBURN ALIU: Është hera e dytë që më jepet rasti ta bëj pyetjen. Herën e parë nuk ka qenë ministri, ministri nuk është as tash, por meqë është mundësia e fundit, unë po e lexoj pyetjen dhe shpresojmë që do të na vijë përgjigja me shkrim.

Pyetja ime ka të bëjë me raportin e fundit për UNMIK-un, për Sekretarin e Përgjithshëm të Ban Ki-Munit, ku në pikën 32 të kapitullit 7, në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe fetare, thuhet që punimet e rindërtimit kanë filluar në tri lokacione të trashëgimisë kulturore të UNESCO-s, e që janë të financuara nga një donacion i Federatës Ruse, e këto janë: Manastiri i Deçanit, Manastiri i Graçanicës dhe Patrikana e Pejës. Pyetja ime i drejtohet ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotit Memli Krasniqit: A është në dijeni për këtë dhe çfarë ka ndërmarrë që të pengohet një financim i tillë nga Rusia në Kosovë?

KRYETARI: Duhet të votojmë. Pauzë 10 minuta, pastaj kthehemi.

(Drejtimin e seancës, pas pauzës, e merr nënkryetari Sabri Hamiti)

KRYESUESI SABRI HAMITI: Zotërinj deputetë, ju lutem uluni ta fillojmë punën!

Më në fund, në sallë janë të pranishëm 77 deputetë. E vazhdojmë punën në seancë. Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 6 dhe 7 shtator 2012

Zotërinj deputetë, a ka vërejtje dikush në këto procesverbale? Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Vërejtja ime ka të bëjë edhe me procesverbalin, por sidomos me transkriptin. Ka qenë një mbledhje solemne, në të cilën nuk ka pasur debat të lirë, por kryesisht debat të shefave të grupeve. Unë dua të reagoj këtu publikisht në diskutimin e zotit Rasim Demiri. Nuk e di a është këtu, edhe pse e pash diku, por në të vërtetë ai në diskutim ka dhënë shumë fakte të pavërteta lidhur me qëndrimin e Komisionit Kushtetues rreth një kërkesë politike, një kërkesë-shkrese rreth të ashtuquajturave “vende të rezervuara”.

Në diskutimin e tij ka përdorur gjuhë joparlamentare dhe është dashur të reagohej nga Kryesia aty për aty, dhe nuk është lënë e drejta e replikës. Ai i ka thënë dy të pavërteta: e para, ai është anëtar i Komisionit dhe e ka ditur se mandati i Komisionit është shumë i limituar, e tha edhe kolegja nga “Vetëvendosje” me të drejtë; dhe e dyta, ai e ka ditur se të drejtën për të propozuar amendamente, sipas Kushtetutës, e ka vetëm kryetari i shtetit - Presidentja e Republikës, Qeveria e Republikës dhe 30 deputetë dhe gjithë kohën ne e kemi udhëzuar në komision që ta ndjekë atë rrugë. Nëse ai ka pasur për qëllim ta arsyetojë para grupit të vet politik mospunën apo joprofesionalizmin është çështje tjetër, por dëshiroj të theksoj se Komisionit Kushtetues asnjëherë, deri sa ka punuar, nuk i ka ardhur asnjë propozim-amendament. Është e vërtetë se ka ardhur kërkesa, siç ka ardhur edhe kërkesa e ministrit Kuçi për amnisti dhe kërkesat tjera, por në formën e amendamentit Komisioni nuk ka pasur të drejtë të bëjë amendamente, sepse kjo është kundërkushtetuese dhe gjithë kohën edhe zëvendëskryeministrin Petroviq, por edhe përfaqësuesit tjerë, i kam udhëzuar që ta ndjekin rrugën kushtetuese që ta procedojnë atë kërkesë, e cila pastaj do të mund të diskutohej në Kuvend vetëm pasi t’i plotësonte konditat që ajo të diskutohej. Sepse, ne kemi marrë mbi 30 shkresa të grupeve të paautorizuara për amendamente, por ne veprojmë vetëm mbi mandatin e Parlamentit mbi procedurën kushtetuese të propozimit të amendamenteve. Kështu që unë dua ta demantoj kolegun Rasim, i cili në një mbledhje solemne sikur u mundua ta keqpërdorë atë dhe sikur u desh të tregohej pak patriot para grupit të vet politik, edhe pse në komision nuk ka qenë shumë i rregullt dhe ne e kemi lutur që ai ta japë kontributin në mënyrë institucionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Tjetër kush? Unë fjalën e kolegut Bajrami e kuptova si shpjegim për një çështje që ka ndodhur në një mbledhje tjetër dhe s’ka pasur mundësi të përgjigjet, sepse nëse teksti e pasqyron atë që është thënë, teksti domethënë nuk është problemi i transkriptit, por është problemi i ndodhisë. Pra, pak a shumë një replikë për një mbledhje të kaluar. A është kështu zoti Bajrami?

Faleminderit! Kush është për miratimin e procesverbaleve? Faleminderit!
Kundër s’ka, besoj. Abstenim s’ka. Tash momentalisht në sallë i kemi 78 deputetë edhe besoj që nuk pakësohen aq shumë për votim.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartimore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional eka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëro!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Më lejoni që në emër të Ministrisë të Drejtësisë ta paraqes para jush për miratim në leximin e parë Projektligjin për procedurën përmbaremore.

Të nderuar deputetë, më lejoni të theksoj që në fillim se me ardhjen time në krye të Ministrisë së Drejtësisë kam vërejtur se ka mundësi që të jetë një sistem gjyqësor më efikas dhe efektiv, në veçanti në zgjidhjen e lëndëve të cilat janë paraqitur para sistemit gjyqësor. Përafërsisht, në Republikën e Kosovës janë mbi 225 milionë lëndë të pazgjidhura dhe në këtë drejtim Ministria e Drejtësisë është munduar ta japë ndihmën dhe kapacitetet e veta. Natyrisht, ne kemi filluar me procesin e noterisë vitin e kaluar, kemi filluar po ashtu me procesin e ndërmjetësimit dhe me procesin e arbitrazhit, që do të ndihmojnë në këtë drejtim. Ne i kemi përgatitur edhe një varg ligjesh që kanë ndihmuar në efikasitetin e gjyqtarëve, e kemi mbështetur me buxhet edhe rritjen e numrit të gjyqtarëve në Republikën e Kosovës, duke i mbështetur ata edhe në formën e stimulimit material. Natyrisht që besimi i qytetarëve në Republikën e Kosovës, në sistemin e drejtësisë, nuk mund të arrihet nëse lëndët e tyre zgjasin për shumë vite. Ky projektligj ka për qëllim efikasitetin dhe rritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura. Përafërsisht, sipas sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, gjysma e lëndëve të pazgjidhura janë në procedurën e ekzekutimit dhe këtu kam vërejtur që ka disa lëshime, disa zbrazëtira ligjore dhe disa mundësi që ne ta përmirësojmë këtë sistem.

Natyrisht, që numri i madh i lëndëve, do t'i quaja përmbaremore, dhe joefikasiteti i ekzekutimit të lëndëve përmbaremore, na bën me dije se Republika e Kosovës ende nuk e ka rregulluar ashtu siç duhet procedurën e përmbaremit, në veçanti në vendosjen e përmbaremit të lëndëve në këtë fushë. Në disa pjesë të ligjit ekzistues për procedurën përmbaremore deri më tani nuk po mund të zbatohet në mënyrë efektive. Ende është i madh numri i vendimeve gjyqësore që nuk po mund të ekzekutohen dhe ky numër po rritet çdo ditë e më shumë. Kjo për arsye subjektive dhe objektive. Ndërsa thelbi i këtyre arsyeve të theksuara është: mungesa e resurseve njerëzore, mbingarkesa e gjykatave me lëndë të ekzekutimit, vështirësitë në terren për ekzekutimin e lëndëve, punët e thella dhe arsye të tjera subjektive.

Me miratimin e këtij projektligji, në rend të parë, të do të mundësohet zbatimi më cilësor i procedurave dhe ekzekutimi më efikas i sistemit të procedurave përmbaremore në nivelin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të pamundësojë grumbullimin e lëndëve, përkatësisht vendimeve gjyqësore që nuk po ekzekutohen. Në këtë projektligj është rregulluar mënyra e organizimit dhe funksionimit të përmbareuesve privatë. Kjo do të jetë hera e parë që në Republikën e Kosovës do të propozohen përmbareuesit privatë dhe këtu kemi marrë për model shtetet rajonit, shtetet e BE-së dhe, në veçanti, shtetin slloven. Natyrisht, që me këtë ligj parashihen qartë detyrat e përmbareuesve privatë, statusi, masat disiplinore ndaj tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, tarifat ndaj tyre, si dhe marrëdhëniet e tyre me institucionet shtetërore dhe me subjektet tjera, qoftë publike, apo private.

Po ashtu, me këtë projektligj është rregulluar dhe procedura e emërimit, e licencimit, e regjistrimit, e çregjistrimit, disiplinimit, largimit, si dhe shkarkimit të përmbareuesve

privatë, duke pasur parasysh koordinimin e plotë ndërmjet aktorëve përgjegjës, në radhë të parë me Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh rrethanat ekzistuese, projektligji pritet të ketë efekte pozitive, në veçanti në zvogëlimin e lëndëve dhe ekzekutimin e vendimeve që janë marrë deri më tani nga gjykatat tona. Ana pozitive e këtij projektligji manifestohet edhe në atë që do ta krijojme një sistem më funksional, që do të ushtrohet nga përmbaruesit privatë.

Me këtë projektligj, vetëm personat e licencuar nuk do të mund të kryejnë procedura ekzekutimi brenda funksionimit të sistemit të përmbaruesve privatë, ku do t'i ushtrojnë funksionet e tyre procedurale përmbarimore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Andaj, i nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, besoj që me miratimin e këtij projektligji në parim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës do të kompletohet edhe më shumë infrastruktura ligjore në sektorin e drejtësisë, do të eliminohen disa zbrazëtira dhe mangësi ligjore dhe do të avancohen standardet më të larta sa i përket sundimit dhe rendit dhe ligjit dhe luftimit të dukurive negative në Republikën e Kosovës.

Ju ftoj që t'i jepni mendimet tuaja, sugjerimet dhe pastaj ta kemi ligjin për miratim në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, e hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji. I pari e merr fjalën kryetari i Komisionit Funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Ky ligj është ndër ligjet më të rëndësishme me të cilat merret Kuvendi, për arsye se ka shumë probleme në sistemin gjyqësor në aspektin e përmbarimit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Dhe, kjo rezulton edhe më shumë probleme, sidomos në ekonominë e tregut të lirë dhe po ashtu me shumë probleme në konteste civile. Ky ligj po ashtu parasheh përmbarimin në realizimin e kredisë në të holla dhe përmbarimin për sendet e luajtshme, përmbarimi për kreditë e debitorit, kalimin-transferimin e kredisë, përmbarimi për të ardhurat personale dhe përmbarimi në të ardhurat e tjera të përhershme në të holla, përmbarimi i kredisë sipas llogarisë në bankë, përmbarimi i letrave në vlerë dhe pjesët në shoqëritë tregtare, përmbarimi në kreditë për dorëzimin e sendeve, përmbarimi për të drejtat pasurore, përmbarimi për sendet e luajtshme, përmbarimi për realizimin e kredisë jo në të holla, përmbarimi me qëllim të dorëzimit të sendeve të luajtshme, përmbarimi për zbrazjen dhe dorëzimin e palujtshmërisë, përmbarimi për realizimin e kredisë për veprime/mosveprim ose durim, përmbarimi i vendimit për ndarjen e sendeve, përmbarimi me qëllim marrjen e deklaratës së vullnetit, përmbarimi me anën e regjistrimit të të drejtave në librin publik, përmbarimi i vendimit për kthimin e punëtorit në vendin e punës, përmbarimi i vendimit nga lëmi i së drejtës familjare dhe dorëzimi dhe marrja e fëmijës. Pra, siç po e shihni, rregullon shumë fusha, të cilat sot në Kosovë janë problematike. Ndër problematikat, në të cilat ndërhyt edhe politika, ju e dini që ka problem me përmbarimin për vendimet që kanë të bëjnë me kontestet e të drejtës së punës, ku shumë vendime gjyqësore janë marrë,

individë të caktuar e kanë fituar të drejtën e kthimit në vendin e punës, e ato vendime kurrë nuk janë ekzekutuar. Ka raste që me vite të tëra njerëzit presin të ekzekutohet vendimi.

Po ashtu, në të drejtën familjare ka shumë probleme, të cilat nuk janë ekzekutuar, dhe ju e dini se arsyetimi i institucioneve financiare, bankave apo institucioneve tjera, të cilat japin kredi në Kosovë, për kamatën e lartë ekziston problem risk shumë i madh në përmbartimin e vendimeve gjyqësore. Dhe, kjo është njëra prej arsyeve të paktën, të cilat bankat dhe institucionet tjera, të cilat japin kredi në Kosovë, e japin si arsyeshmëri për riskun e lartë të tyre dhe për normën e lartë të kamatës së interesit.

Dhe, besojmë që ky ligj do të ndikojë pozitivisht, ose të paktën ishte dashur të ndikojë pozitivisht edhe te norma e interesit dhe te rregullimi i marrëdhënieve civile. Po ashtu, ky ligj parasheh edhe përmbartuesit privatë, mandatin dhe kompetencën, emërimin, betimin, provimin e përmbartuesit privat, të drejtat dhe obligimet për përmbartuesit privat, mirëmbajtjen e evidencave afariste, pasqyrat e shpenzimeve, zëvendësimin e përmbartuesit privat, mbikëqyrjen, kontrollin, përfundimin e përmbartuesit privat, pezullimin dhe lirim nga detyra. Po ashtu, parasheh edhe disa elemente tjera: odën e përmbartuesve privatë të Kosovës dhe dispozitat tjera, të cilat i rregullojnë këto fusha. Mirëpo, duhet të kemi parasysh edhe disa elemente tjera, se Ministria e Financave në deklaratën e vet financiare ka thënë që dyshon që mund të ketë burime të mjaftueshme financiare për ta përballuar këtë ligj, megjithëse kostoja e tij është shumë e ulët, diku 42 000 euro, dhe beneficioni nga ky ligj është shumë i lartë, sepse përfiton edhe ekonomia e tregut të lirë, përfitojnë edhe marrëdhëniet civile dhe përfiton po ashtu edhe sistemi i bankave, e do të duhej të ndikonte edhe në sistemin e kamatave.

Mirëpo, ministria e ka dhënë këtë vlerësim, me të cilin e detyron Ministrinë e Financave që ta përballojë këtë shpenzim duke i reduktuar shpenzimet tjera, ndërsa Ministria e Drejtësisë nuk e ka dhënë një përgjigje se a do të mund ta përballojë, megjithëse unë jam i bindur që mund. Kostoja fillestare është 31 000 euro, pastaj çdo vit 42 000 euro, e beneficioni mund të jetë me miliona euro për ekonominë e tregut të Kosovës. Dhe, mendoj se duhet të ketë një harmonizim më të mirë ndërmjet ministrive kur vijnë ligjet e kësaj rëndësie, sepse, pas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, ky është ligji kryesor që e rregullon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, po ashtu kontesteve civile dhe duhet të ketë një seriozitet më të madh nga Qeveria në trajtimin e këtij ligji.

Gjithsesi, si komision, e kemi trajtuar dhe e kemi vlerësuar që duhet të kalojë në parim dhe besoj që deputetët do ta shqyrtojnë këtë ligj me kujdes të veçantë, sepse është i rëndësishëm së veçantë për ekonominë e tregut, për rregullimin e marrëdhënieve civile dhe për rregullimin e marrëdhënieve kreditore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve politike parlamentare. Për Grupin e PDK-së, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Projektligjin me vëmendje dhe ka vërejtur se aty është punuar me mjaft përkushtim nga Ministria e Drejtësisë dhe gjithë zbrazëtitë dhe mungesat do t'i trajtojmë në Komisionin Funksional dhe do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon që në vazhden e reformës së sistemit të drejtësisë ky projektligj, me risitë që përmban, e ka votën e grupit tonë parlamentar, për arsye që i theksoi edhe kryetari i komisionit, i cili i trajtoi procedurat që nga zbatimi, por edhe ekzekutimin.

Në sistemin tonë të drejtësisë, ligji aktual ka pasur zbrazëtitë ligjore për dy arsye, jo vetëm te procedurat përmbauese, por edhe te ekzekutimi i lëndëve gjyqësore, të cilat kanë lënë shenjë të keqe në sistemin e drejtësisë te gjykatat vendore nga numri i lëndëve të grumbulluara. E dyta, ekzekutimi i lëndëve gjyqësore, disa që unë do t'i quaja të rëndësishme së veçantë edhe për institucionet e Republikës së Kosovës, por edhe për vetë publikun, sepse ne e kemi ende njerëz të dënuar, të cilëve nuk u ekzekutohet lënda, apo nuk shkojnë për ekzekutimin e dënimit të vuajtur, si kryetar komunash, por edhe njerëz tjerë të institucioneve relevante në Republikën e Kosovës.

Prandaj, për këto arsye, ky ligj, me gjitha këto risi, e avancohet sistemin e drejtësisë dhe kontributi ynë do të jetë shumë parimor edhe në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën përmbauese, projektligj i cili ka për qëllim të rregullojë procedurat për zbatimin e përmbaimit, marrëdhëniet ndërmjet kreditorit e debitorit dhe e konsiderojmë si mjaft të rëndësishëm.

Sigurisht që kemi hasur në vërejtje teknike, por edhe përmbajtëse, për thënë të drejtën, është shumë e vështirë të bëhen ndryshime pa pasur një bashkëpunim të gjerë me përfaqësuesit e institucioneve që janë të obliguara ta zbatojnë këtë ligj, të preken direkt apo indirekt me këtë ligj.

Konsideroj që është shumë e rëndësishme që pas këtij shqyrtimi të bëhen dëgjime publike me grupet e interesit dhe ta rregullojmë në detaje secilën procedurë apo afat edhe në grupet punuese. Lëvizja “Vetëvendosje”, për shkak të shumë neneve të mira që parashihen në këtë ligj, do ta votojë, mirëpo mendojmë që në fazën nëpër të cilën po kalojmë është shumë e rrezikshme që të kemi përmbaues privatë, pra shumë thjesht licencën mund ta marrin ata njerëz, të cilët janë të lidhur ngushtë me pushtetin dhe konsiderojmë që të gjitha nenet që përfshihen në këtë ligj për përmbauesit privatë duhet

të hiqen, pra duhet të amendamentohen në atë mënyrë që të hiqen. Diçka tjetër që ne kemi vënë re, për të cilën nuk e dimë arsyen, është edhe hyrja në fuqi e këtij ligji, pra e projektligjit. Pra, thuhet që neni 323 dhe 398 hyjnë në fuqi menjëherë, ndërsa nenet tjera më 1 janar 2014, andaj konsideroj që është e rëndësishme që ministri i Drejtësisë të na japë një shpjegim në lidhje me këtë, duke marrë parasysh që ky ligj duhet të hyjë në fuqi menjëherë për shkak të rëndësisë që ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës beson se ky Projektligj definitivisht e rregullon njërin prej fushave që ka tepër rëndësi dhe që lidhet drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve. Pa dashur t'i përsëris ato që i thanë kolegët, besojmë që ka shumë raste të mosekzekutimit të lëndëve gjyqësore në fushën e kthimit të vendeve të punës për qytetarët, të cilëve u janë shkelur të drejtat në kuptimin e largimit prej vendit të punës pa të drejtë dhe ku të gjitha shkallët e gjykatave në Kosovë kanë vendosur në favor të kësaj. Unë po e përmend një rast, që vërtet është eklatant, ai i Viktor Markut, në Klinë, në të cilin rast kanë kaluar të gjitha nivelet e gjykatës deri në Gjykatën Kushtetuese, madje Gjykata Supreme i rekomandon këtij qytetari që ta fillojë procesin penal kundër kryetarit të Komunës dhe një departamenti brenda Komunës, që assesi nuk e marrin përgjegjësinë për të vendosur ekzekutimin e asaj që është thënë në të gjitha nivelet e mundshme të gjykatave në Kosovë.

Besojmë se këto probleme janë të shumta. Unë e mora një shembull, i cili është definitivisht për nivele politike dhe ka pasur vendim politik për largimin e tij nga puna, por ekzekutimi i vendimeve gjyqësore definitivisht ka ngecur. Kjo besojmë që duhet të kalohet ose të tejkalohet në mënyrën e përcaktuar edhe me këtë ligj. Ne do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën përmbartimore. Konsiderojmë se është një projektligj i rëndësishëm dhe i nevojshëm dhe të njëjtin në parim e përkrahim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Albert Kinolli, për Grupin Parlamentar "6+".

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Pas shqyrtimit të Projektligjit për procedurën përmbartimore, Grupi Parlamentar "6+" mendon se ky projektligj është mjaft i rëndësishëm dhe i nevojshëm dhe se do ta

përmirësojë efikasitetin për procedurën përbarimore dhe do të jetë në favor të qytetarëve.

Prandaj, Grupi Parlamentar “6+” do ta miratojë në parim, kurse kontributin tonë do të japim nëpërmjet punës në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! As në emër të grupeve, as si deputet individualisht, nuk ka paraqitje tjera. Atëherë unë kërkoj nga përfaqësuesi i Qeverisë, që ta marrë fjalën. Unë i dëgjova edhe dy pyetje. Si të doni.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për qasjen dhe për mbështetjen në parim të gjitha grupet parlamentare. Më lejoni t’i jap dy sqarime, një që ka të bëjë me vërejtjen e deputetit Gashi dhe një të deputetes Haxhiu.

Deputeti Gashi e përmendi aspektin financiar të implementimit të ligjit dhe unë dua të them që është një shumë - shumë e vogël, e cila nuk ka nevojë të kalojë as në Ministrinë e Financave, apo diku tjetër. Por, Ministria e Drejtësisë shumë prej rreth 30 000 eurove nga subvencionet e veta, apo nga shpenzimet e zyrës së ministrit, mund ta bartë, por na jep një garanci të fortë që tre muaj pas hyrjes në fuqi të fillimit, do të thotë të përbaruesve privatë, buxheti i Kosovës do të fitojë shumë më shumë, por mbi të gjitha do të përfitojnë qytetarët, ngase lëndët e tyre presin me vite në përbarim, apo në ekzekutimin e tyre, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shumatat e tyre materiale. Por, mbi të gjithë, unë besoj që do ta nxisë aktivitetin ekonomik në vendin tonë dhe do t’i nxisë njerëzit, të cilët do të bëjnë investime të ndryshme në vendin tonë, ngase kërkesat e tyre do të përbarohen.

Sa u përket dy vërejtjeve nga deputetja Haxhiu: e para, sa u përket përmirësimeve, unë personalisht, por edhe stafi im, jemi të gatshëm që të vijmë në komision dhe të japim sqarime një nga një. Pajtohemi që mund të ketë ndonjë vërejtje teknike, por edhe për ato përmbajtjesore do të jemi të gatshëm që të marrim pjesë në komision dhe t’i japim edhe sugjerimet tona, por edhe për ato si çështje tuaja ne do të pajtohemi. Por, ajo çka mund të themi është një - çështja e licencimit të përbaruesve privatë. Ata që e kanë lexuar me vëmendje ligjin, licencimi nuk bëhet nga Ministria e Drejtësisë dhe këtë e kam bërë unë - shumë vende e bëjnë nga Ministria e Drejtësisë. Është një bord i pavarur, që do ta zgjedhë Kuvendi, dhe ai do ta bëjë këtë licencim, sepse nuk dua ta bartë barrën e fillimit të përbaruesve privatë nga Ministria e Drejtësisë. Shembull mund t’i kemi Maqedoninë dhe Slloveninë, që janë shembuj të suksesshëm.

Çështja e dytë ka të bëjë me përbaruesit privatë, që e përmendët ju: unë zonja deputete, në filozofinë time politike dhe esenca e këtij ligji janë përbaruesit privatë dhe këtu duhet të ketë, besoj edhe deputetë tuaj që jetojnë në vendet e tjera, e dinë që punën kryesore e bëjnë përbaruesit privatë dhe në momentin që heqim përbaruesit privatë, konsideroj se duhet ta heqim edhe ligjin në tërësi.

Dhe çështja e fundit, që e përmendët, me hyrjen në fuqi në vitin 2014, ky ligj deri në leximin e dytë nuk mund të vijë, sipas të gjitha gjasave, deri në muajin nëntor. Në vitin tjetër, ne duhet të bëjmë përgatitje për këtë. Na duhet strukturë, na duhen udhëzime administrative, na duhen licenca, na duhet bordi – themelimi i bordit, na duhen veprime të tjera për disiplinim, për emërim dhe nuk guxojmë të hyjmë të papërgatitur. Dhe, unë kam menduar që për një vit mund t'i bëjmë të gjitha përgatitjet që në vitin kalendarik 1 janar 2014, të fillojmë me përmbauesit privatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi, për sqarim!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Thjesht, sa për sqarim me ministrin. Unë e citova dokumentin zyrtar të Ministrisë, i cili parasheh për vitin 2012 - 21.200 euro, për vitin 2013 - 42.400 euro, për vitin 2014, të njëjtën shumë dhe për vitin 2015. Po lexoj përfundimin e Ministrisë së Financave.

“Departamenti i Buxhetit shpreh opinionin e vet për ndikimin buxhetor të këtij projektligji, sipas të cilit vlerësohet se kemi të bëjmë me një propozim i cili do të ketë kosto shtesë buxhetore dhe se zbatimi i tij kërkon mjete shtesë. Koston shtesë për periudhën 2012-2015, Ministria sponsoruese duhet ta mbulojë nga kursimet që do të evidentohen nga programet aktuale. Në të kundërtën, ky projektligj nuk mund të ketë mbështetje shtesë buxhetore.”.

Këtë unë e citova dhe kërkoja që të ketë më shumë harmonizim ndërmjet ministrive.

Unë e di që ministri do t'i gjejë parat dhe besoj se do t'i gjejë. E di që është një kosto shumë e ulët dhe, e thashë edhe herën e parë dhe po e përsëris, është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm për ekonominë e tregut, rregullon një çështje shumë të rëndësishme që është, përmbarimi i vendimeve gjyqësore dhe përmbarimi i konflikteve civile dhe konflikteve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e problemeve që dalin te bankat. Po ashtu, krijon mundësi që të kemi një perceptim më të mirë të investitorët e huaj se kemi mundësi të realizimit të kontratave e të marrëveshjeve.

I vetmi shqetësim, po ashtu që unë i ndaj të dyja, edhe shqetësimin me Albulenën, por edhe shqetësimin me ministrin, është hyrja në fuqi. Po më duket është shumë larg hyrja në fuqi, por në të njëjtën kohë duhet të përgatitet sistemi dhe është goxha vështirë të përgatitet.

Prandaj, mendoj se duhet një angazhim më i madh i të gjitha palëve të interesuara që të zgjidhet ky problem.

Kjo ishte ajo që unë kërkoja si sqarim, se e citova një dokument zyrtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi më kurrfarë diskutimesh. Ju lutem, deputetë të nderuar, tash do të bëjmë deklarinë për miratimin në parim të projektligjit. Në sallë kemi 76 deputetë, prandaj lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash.

Me 70 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, miratohet Projektligji në parim.

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj rregullon: themelimin, misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Në programin legjislativ të Qeverisë, është paraparë që të krijohen programe për projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e komplekseve memoriale.

Agjencia është përgjegjëse për komplekset memoriale, të shpallura me vendim të Qeverisë, si zona të veçanta me interes kombëtar dhe karakter historik.

Me këtë projektligj parashihet funksionimi i agjencisë, si institucion përgjegjës në kuadër të nivelit qendror, me të cilin përcaktohet veprimtaria e saj pas nxjerrjes së akteve nënligjore.

Agjencia bashkëpunon me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, komunat përkatëse dhe organizata të ndryshme për projekte që kanë të bëjnë me këto zona.

Projektligji për Agjencinë, përbëhet prej katër krerëve dhe 13 neneve.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet që janë të përafërta me dispozitat përkatëse të Bashkimit Evropian. Ju falënderoj për përkrahje.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani e ka fjalën. Si duket, nuk e do fjalën.

Atëherë, kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për Grupin e PDK-së, fjalën e ka kërkuar Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit!

Të nderuar qeveritarë të Kabinetit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Kosovë kemi pasur një kaos rreth projektimit, ndërtimit, menaxhimit dhe përkujdeset për komplekset memoriale, me të cilat janë marrë strukturat dhe institucionet e ndryshme, shpesh të ngritura në mënyrë vullnetare dhe pa prioritet të përcaktuara.

Edhe iniciimi i këtyre nismave shpesh është bërë pa kritere profesionale dhe me ndikime politike dhe janë zbatuar sipas preferencave të vendimmarrësve duke bërë dallime sipas fuqisë politike që i kanë përfaqësuar iniciuesit në institucione.

Edhe mbështetja financiare për ngritjen e tyre ka ndjekur pothuaj se të njëjtën logjikë. Për këto arsye, një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vlera modeste artistike dhe me vështirësi do t'i qëndrojnë kohës.

Shumë shpesh, për shkak të mundësive të kufizuara buxhetore, komplekset memoriale, të cilat janë ngritur me mund të madh, iu kanë lënë stihisë dhe janë dëmtuar rënd nga njerëzit dhe moti.

Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz ka dhënë rekomandim të saktë për nevojën e menaxhimit të këtyre komplekseve dhe memorialëve dhe ka justifikuar nevojën e formimit të kësaj agjencie për ngritjen dhe menaxhimin të këtyre komplekseve, i cili do të merret me administrim dhe menaxhim të këtyre projekteve në nivel kombëtar. Kjo agjenci do të bëhet institucion përgjegjës për komplekset memoriale të shpallura nga Qeveria si zona të veçanta me interes kombëtar dhe karakter historik.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në mbledhjen e fundit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe i ka rekomanduar këtij Kuvendi që ta miratojë në parim. Ne vërejtjet tona do t'i japim pastaj në punën e mëtutjeshme të Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën për LDK-në e ka Afërdita Berisha- Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji, siç theksoi edhe ministri, rregullon: themelimin, misionin, organizimin, funksionin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Ky projektligj, sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si organ propozues, prodhon kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe atë 25.654.868 euro, si dhe përfshin punësimin e 47 zyrtarëve të rinj.

Departamenti i Buxhetit vlerëson se kemi të bëjmë me një propozim i cili do të ketë shtesë buxhetore për vitin 2012 - 2015, jashtë financimeve të kornizës afatmesme të shpenzimeve 2013 - 2015 dhe kornizës buxhetore 2013 - 2015.

Meqenëse ky projektligj ka implikime buxhetore, ne kërkojmë jo vetëm të miratohet, por edhe të gjenden mjetet për implementim.

Vërejtjet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, janë që të mos ketë limitime Agjencia gjatë inicimit të propozimeve për komplekse memoriale, domethënë, të mos përfshihet vetëm periudha 1998 - 1999, por mendojmë që duhet të përfshihen të gjitha ato komplekse memoriale që prezantojnë historinë e kombit në kontinuitet nga lashtësia e deri më sot.

Gjithashtu, Agjencia duhet të përcaktojë standardet e unifikuara me qëllim që të gjitha kompleksët memoriale të marrin karakter nacional.

Vërejtje tjetër e Lidhjes Demokratike të Kosovës është që bashkëpunimi i Agjencisë të jetë edhe më i gjerë, duke përfshirë edhe Akademinë e Shkencave, Institutin e Historisë, Institutin Albanologjik dhe institucionet tjera relevante.

Meqenëse kompleksët memoriale pasqyrojnë ngjarje me rëndësi kombëtare, mendojmë se është mjaft e rëndësishme që Agjencia të krijojë bashkëpunim të përhershëm me institucionet relevante të Republikës së Shqipërisë.

Në parim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e voton në leximin e parë këtë projektligj, me qëllim që vërejtjet e cekura të merren parasysh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Po ky projektligj është projektligj për Agjencinë dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe më pak është për shpalljen e memorialëve të Kosovës dhe më pak është për procedurat për shpalljen e atyre memorialëve. Pra, bëjmë fjalë për menaxhimin, duke e lënë anash procesin e shpalljes.

U tha këtu që deri më tani ka pasur ndërtim në mënyrë kaotike. Nëse ka pasur ndërtim në mënyrë kaotike, na duhet ligj që e rregullon procesin e shpalljes, pra procesin e krijimit të memorialëve të cilat janë me vlerë, natyrisht, e jo të merremi drejtpërdrejt me menaxhimin e tyre dhe me procesin e projektimit, të ndërtimit, administrimit e kështu me radhë.

Pra, shumë më e vlefshme është procedura se si shpallen ato, cilat janë kriteret për shpallje, kush bashkëpunon në atë shpallje, e jo të thuhet vetëm që Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë, është përgjegjëse për kompleksët memoriale të shpallura me vendim të Qeverisë. Pra, procesi i shpalljes është kaq.

Shumë më e vlefshme është shpallja se sa menaxhimi. Menaxhimi është dytësor, e ne Ligj për komplekset memoriale, përkatësisht për mënyrën se si ato shpallen nuk kemi, po kemi nevojë të kemi agjenci, sepse agjencia ka pastaj nevojë për buxhet 25 milionë dhe ka nevojë për të punësuar njerëz të tjerë. Kjo mendoj se është çështje së prapthi në këtë problematikë.

Natyrisht, kur bëhet fjalë për projektim dhe çështjet e shpalljes, duhet të qartësohet qartë edhe bashkëpunimi me Asociacion të Arkitektëve, e kështu me radhë, sepse memorialet kudo në botë kanë një vlerë të jashtëzakonshme dhe çështja e dizajnit të tyre është vlerë, është çështje tejet me rëndësi në këto memoriale.

Pra, unë mendoj që ky projektligj më shumë mendon për krijimin e një agjencie dhe për të punësuarit aty se sa për memorialet.

Po ashtu, duhet të definohet agjencia në Qeveri. Si raportohet, si zgjidhet, mënyrën se si vepron, e jo vetëm të jepet në këtë mënyrë, kështu si është dhënë deri tash?

Pra, kështu si është ky projektligj e lë mundësinë që të dyshohet për jo seriozitet. A që kemi nevojë për komplekse memoriale dhe se kemi nevojë që ato të ndërtohen në mënyrë të rregullt, që të ketë një procedurë të qartë për shpalljen dhe ndërtimin e tyre, ajo është shumë e qartë. Prandaj, në parim ne do ta votojmë, por jam i bindur që nëse vërejtjet që u dhanë nuk do të inkorporohen, ky ligj thjesht do të krijojë një agjenci ku do të punësohen, sikur shumë e shumë agjenci të tjera, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër përpos shpërndajnë rroga dhe efekti i tyre është, madje – madje dhe shpeshherë i parregullt, nuk çon drejt rregullit, por në fakt e shkatërron dhe prishë rregullin në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Komplekset memoriale në Kosovë deri sot nuk kanë qenë të financuara ose të trajtuara nga shteti. Këto komplekse janë ngritur me mund të madh, me donacione të grumbulluara, por niveli dhe kualiteti i tyre nuk kanë qenë në nivel.

Mendoj se është bërë një hap shumë pozitiv nga Qeveria që këto komplekse, me rëndësi historike, të menaxhohen nga Agjencia e lartcekur.

Komplekset memoriale janë vlera historike që prezantojnë luftën dhe përpjekjet e popullit në luftën për lirinë e vendit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe në parim do ta përkrahë. Vërejtjet dhe sugjerimet do t'i adresojmë përmes Komisionit parlamentar për Bujqësi, gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Themelimi i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ka qenë një nevojë e hershme, për shkak se në terren na janë paraqitur probleme të cilat në disa raste kanë pasur pasoja dhe janë reflektuar negativisht te qytetarët. Një përvojë të tillë të hidhur e kemi pasur edhe ne në Gjakovë, nga i cili një pjesë e qytetarëve atje janë ndie jashtëzakonisht të dëshpëruar me rastin e vendosjes së një memoriali nga ana e komunës, pa u konsultuar me ta, kështu që themelimi i kësaj agjencie i hap rrugën administrimit dhe menaxhimit të kësaj gjendjeje, ku presim ta fusë në binarë institucional të mirëfilltë rregullimin e tyre.

Ne, si Grup Parlamentar, e përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući! Parlamentarna grupa “6+” je pažljivo analizirala Nacrt zakona o Agenciji za menadžiranje memorijalnih kompleksa. U principu Nacrt zakona je dobro urađen što ga veoma čini jednostavnim za čitanje. Parlamentarna grupa 6+ podržava ovaj Nacrt zakona i svoj doprinos daćemo kroz rad komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, deklarime të grupeve tutje nuk kemi. Ju njoftoj se i kemi 7 deputetë që janë paraqitur për diskutim. Mbani mend emrat, sepse unë nuk do të kombinoj, por do ta marrin fjalën sipas rendit që janë paraqitur. Këta janë: Arben Gashi, Hykmete Bajrami, Bekim Haxhiu, Lirije Kajtazi, Haki Demolli, Gëzim Kelmendi dhe Halit Krasniqi. Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë thjesht e mora fjalën për të përshëndetur ligjin dhe avancimin e mendimit politik në ligjbërje në Kosovë, sepse më kujtohet në fillim të viteve 2000, ngjarjet që ndodheshin, e sidomos më specifike, kanë qenë ngjarjet që ndodheshin në komunën e Prizrenit, ku në atë kohë kryetar komune ishte, sot kolegu ynë i nderuar Eqrem Kryeziu dhe pikërisht kishte një vizion në të cilin thoshte se në Kosovë, memorialet duhet të vendosen sipas ligjit dhe të respektohen e të ketë një sistem i cili ndërton, menaxhon dhe mirëmban memorialet.

Më kujtohet që shumë njerëz në atë kohë kishin një qëndrim agresiv, arrogant, bile-bile kishte edhe kërcënime fizike për zotin Kryeziu, se nuk po do t’i respektojë heronjtë e luftës, njerëzit që kanë dhënë kontribut. Mirëpo, vizioni i tij, mesa e kam kuptuar unë në atë kohë dhe e kuptoj sot, ka qenë dhe është që të ketë një sistem i cili ka përgjegjësi për memorialet historike, dhe për memorien tonë kombëtare. Atëherë, qëllimisht, ose keqkuptohej ose keqinterpretohej, bile kërcënohej dhe shantazhohej shpesh.

Ndoshta unë po flas në emër të zotit Kryeziu, pa konsultim me të, mirëpo ky ishte unë çfarë e kam kuptuar në atë kohë dhe sot, 12 vjet pas luftës, është një arritje e mirë që e kemi një ligj i cili do t’i menaxhojë dinjitetshëm, se atëherë ka qenë qëllimi i zotit Kryeziu, sot është qëllimi i Kuvendit që të menaxhohen dinjitetshëm memorialet tona, që

njerëzit të cilët kanë rënë për Kosovën, që kanë memoriale, kanë buste - memorialet e tyre dhe bustet e tyre të mos mbeten të pamirëmbajtura, të patrajtuara dhe të pamenaxhuara.

Prandaj, mendoj se është një lëvizje shumë e mirë. Fatkeqësisht, i keq është fakti se Ministria e Financave ka thënë që nuk ka buxhet për këtë ligj dhe nuk mund ta përballojë buxheti i Kosovës këtë ligj, ndërkohë që ligji hyn në fuqi 15 ditë nga shpallja e tij. Ky është një problem, të cilin ministri, normalisht, ishte dashur t'ia sqarojë Kuvendit, se ku mendon se do t'i gjejë ato para, si do të funksionojë kjo agjenci, sepse ligji i ka krejt 15 nene dhe formulimet aty janë se Agjencia do të funksionojë sipas standardeve më të mira të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare, ndërkohë që ne në ligj ne duhet të përcaktojmë se si duhet të funksionojë dhe çka është standard nuk përcaktohet as në ligj as me ndonjë rregullore tjetër - cili është standardi më i mirë i Kosovë e i cili është standardi më i mirë ndërkombëtar për menaxhimin e komplekseve memoriale?

Prandaj, mendoj se ligji duhet të jetë më specifik dhe Komisioni duhet ta ketë parasysh që të shohë se si me amendamente ta pasurojë dhe ta përmirësojë këtë ligj, sepse ligji i ka 15 nene ku kryesisht nenet janë përshkrim çka është memoriali, si funksionon memoriali dhe në fund kur hyn në fuqi ky ligj dhe asgjë në lidhje me agjencinë, si organizohet agjencia, si funksionon agjencia, si jap përgjegjësi, në ndërkohë që kemi një përshkrim aty te deklarata buxhetore se kostoja financiare e këtij ligji është shumë e lartë dhe po ashtu kemi edhe një element tjetër ku me këtë ligj do të punësohen 47 persona në kuadër të Agjencisë? Pastaj do të kemi edhe probleme tjera, si do të jetë po ashtu angazhimi i kompanive, profesionale, të cilat do të mirëmbajnë territoret, do t'i mirëmbajnë dhe menaxhojnë hapësirat që konsiderohen komplekse memoriale e tjera.

Prandaj, mendoj se ligji si i tillë është i keq, mirëpo qëllimi është i mirë. Dhe unë do të votoj për qëllimin, jo për ligjin. Prandaj, votoj për qëllimin e tillë dhe besoj se do të kemi diçka pozitive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Askush nga Grupi ynë Parlamentar nuk është kundër memorialëve. LDK-ja gjithmonë respekton dhe përulet para atyre që dhanë jetën përgjatë gjithë historisë dhe jo vetëm dëshmorëve të luftës së fundit, sepse ka tendenca që historia e Kosovës, edhe me libra të historisë edhe me gjithçka tjetër, të fillojë vetëm prej ekzistimit kur disa persona kanë dalë në sipërfaqe.

Ne, rrjedhimisht nuk jemi kundër këtij projektligji, u tha disa herë. Ne jemi kundër tendencës, jemi shumë kundër mënyrës se si ministrinë nuk i harmonizojnë veprimet dhe mendimet e tyre.

U fol këtu për deklaratën financiare që vjen nga Ministria e Financave. Thuhet qartë se kostoja e ligjit për vitet 2013 - 2015 është 25,6 milionë euro. Kërkohej të punësohen 47 veta, edhe kjo u përmend.

Unë e kam vetëm një pyetje. Ia parashtoj edhe përfaqësuesve të Qeverisë po edhe deputetëve të këtij Kuvendi - Cila është poenta që një ligj të shkojë para se të vijë në Kuvend në Ministrinë e Financave? Cila është rëndësia e deklaratës financiare? A është njëjtë, sikur kur thuhet që - kemi para që ta zbatojmë ligjin, sikur kur thuhet që nuk ka para për ta zbatuar ligjin?

Unë jam shumë e sigurt që përfaqësuesit e Qeverisë do të gjejnë para për të financuar rrogat e 47 militantëve të PDK-së, por nuk jam aspak e sigurt që çdo vit, në vazhdimësi, do të gjenden 8,5 milionë për shpenzimet kapitale të këtyre memorialëve.

Andaj, jam kundër që në Kuvend të vijnë ligje të pa harmonizuara. Bile Ministria e Financave nuk guxon as të thotë në deklaratën e saj financiare që nuk ka buxhet, dhe ne nuk aprovojmë shkuarjen e këtij ligji në Kuvend. Ajo vetëm tregon se këto para nuk janë të parashikuara në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013 - 2015.

Unë e kam edhe një pyetje për ministrin e resorit - A është konsultuar ky gjatë përpilimit të kornizës afatmesme të shpenzimeve? Nëse nuk jeni konsultuar, i nderuar ministër, a e keni lexuar ndonjëherë kornizën afatmesme të shpenzimeve, se ne kemi dëshirë të bëjmë shumëçka, por mundësitë buxhetore janë ato që janë dhe ju duhet t'i respektoni. Ne nuk duhet të manipulojmë këtu me opinionin publik dhe me familjet e dëshmorëve dhe të rënëve përgjatë gjithë historisë së Kosovës. Ju votat e opozitës sot i merrni, nëse i merrni, për hir të atyre që ne të mos dalim që jemi kundër memorialëve, por assesi nuk i merrni për një punë që e keni bërë dhe për një ligj të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Bajrami. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Fillimisht dua të përgëzoj Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për punën e bërë për hartimin e këtij projektligji për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

Të nderuar kolegë, ju e dini që në të gjitha diskutimet e mia për Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës, unë kam kërkuar të ndahen mjete për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale, e në veçanti për kompleksin memorial të Jasharëve në Prekaz. Prandaj, mendoj që me anë të këtij ligji njëherë e përgjithmonë do të zgjidhen problemet e mirëmbajtjes dhe përkujdeset për komplekset memoriale.

Ky ligj rregullon: themelimin, organizimin, funksionimin dhe detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë, por gjithsesi edhe të komplekseve memoriale. Mendoj se këtu, sa

u përket kriterëve, ato duhet të përcaktohen qartë për komplekset memoriale, e që besoj se kjo çështje do të plotësohet gjatë amendamentimit të këtij ligji.

Mendoj gjithashtu që edhe te statusi i Agjencisë, kjo agjenci mendoj se do të ishte mirë të funksiononte në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe te neni 5, mendoj që gjithsesi duhet të shtohet, përveç tjerave që janë aty, do të thotë edhe rirregullimi dhe mirëmbajtja e komplekseve memoriale.

Mendoj që ky ligj definitivisht do të rregullojë një çështje e cila i ka munguar dhe deri më tani ato komplekse të ngritura në kapacitete të personave të ndryshëm dhe individuale tani do të hyjnë në përkujdesje shtetërore. Mendoj që ndoshta për shkak të implikimeve buxhetore do të ishte mirë që disa komplekse edhe do të jenë në menaxhimin e komunave apo Agjencia të ketë sektorë të vet nëpër komuna me qëllim të menaxhimit më të mirë të komplekseve memoriale.

Edhe një herë e përgëzoj Ministrinë për punën e bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Duke ju përshëndetur të gjithëve, dua të flas pak në këtë drejtim, edhe pse u thanë disa gjëra. Megjithatë, nuk po ndalem te ajo pjesa që është parë si defekte në këtë kategori se në fakt projektligjet vijnë për këtë arsye, ligjet vijnë për t'i koduar gjërat të cilat manifestojnë ndoshta defekte në punë. Të gjithë e kemi pëlqyer nevojën përkujdesje nga institucionit dhe me këtë e shprehim edhe përkrahjen tonë në këtë drejtim, por po them se ky dokument në këtë rast më shumë i ngjan një shpalljeje apo një vendimi të Qeverisë, se sa që është i formuluar si projektligj, ngase nuk rregullon asgjë, përpos asaj që tregon se themelohet një agjenci, do të thotë një vendim dhe asnjëherë për ndonjë standard të punës dhe të kriterëve që duhet t'i ketë agjencia, qoftë për shpallje, qoftë për punën dhe detyrat e veta.

Në këtë rast edhe shtrohet pyetja, çka në fakt nuk ka mund të bëjë Departamenti, që avancohet në agjenci, kur ky projektligj thashë nuk precizon për më shumë, ose nuk premtan për më tepër. Dhe dua të përmend atë se më herët kemi parë shumica prej neve shqetësimet e komunitetit të kulturës, ngase memorialet tona, me ndonjë përjashtim, nuk paraqesin edhe atë pjesën tjetër që quhet dorë artistike, që është më se e nevojshme për t' i rezistuar kohës dhe për të ditur për t'iu përkulur njerëzit asaj që prezanton një vlerë.

Pa përmendur, po pa veçuar dhe ndoshta pa guxuar të përmend figura shqiptare, po e përmend shtatoren e presidentit Bill Clinton. Është fund e krye në disharmoni apo në disproporcion ajo që paraqet fizionomi të ndërtimit që prezanton ajo shtatore dhe në këtë drejtim ato e devalvojnë edhe figurën e një qoftë humanisti, qoftë atdhetari apo çka në fakt pasqyron memorialin.

Prandaj, do të isha angazhuar dhe kisha dashur që shumica të punojnë që projektligjit t'ia japin formën e një ligji, jo thashë të një vendimi, që përpos se thotë që punësohen disa njerëz, nuk është kah bën diçka tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Vërejtjet e mia, lidhur me këtë draftligj kryesisht kanë të bëjnë me nenin 1 të tij, sepse në këtë nen theksohet. Ky ligj rregullon themelimin, misionin, organizimin, funksionin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Por kur lexohen dhe analizohen nenet pasuese të këtij draftligji, atëherë shihet se me këtë ligj nuk rregullohet fare organizimi dhe struktura organizative e kësaj agjencie. Ç'është e vërteta, në nenin 8, i cili titullohet: Struktura organizative e Agjencisë, theksohet se strukturat dhe organizimi i Agjencisë rregullohet me akt nënligjor të Qeverisë.

Po qe se çështje kaq të rëndësishme, siç është organizimi i Agjencisë rregullohen me akt nënligjor, atëherë shtrohet pyetja - pse duhet përpiluar dhe aprovuar një draftligj i tillë, i cili nuk rregullon çështje të tilla vitale, të cilat janë theksuar edhe në vetë qëllimin e ligjit.

Po ashtu edhe përcaktimi i kriterëve për emërimin dhe përzgjedhja e kryeshefit të Agjencisë, nuk është rregulluar në mënyrë të kënaqshme, apo ashtu siç do të duhej të rregullohej me një ligj të kësaj natyre. Në vend se draftuesi në këtë draft që ka gjithsej 13 nene t'i shtojë edhe 2-3 nene tjera, në të cilat do të theksoheshin: kriteret, procedura, mandati, emërimi, shkarkimi si dhe çështjet tjera të rëndësishme për kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë, hartuesi i ligjit në nenin 10, përdor një formulë tejet të përgjithshme duke e adresuar zbatuesin, por edhe lexuesin e këtij ligji në dispozita përkatëse në fuqi të Republikës së Kosovës.

Mendoj se rregullimi joadekuat, përkatësisht përcaktimi se çështjet e strukturës organizative të agjencisë dhe kryeshefit ekzekutiv të saj të rregullohen me akt nënligjor, përkatësisht me dispozita tjera që janë në fuqi, nuk është bërë për shkak të mosdijes apo jo profesionalizmit të hartuesve të ligjit, por është bërë për shkaqe dhe me motive politike, në mënyrë që Qeveria të fuqizohet në raport me Kuvendin. Kështu, për shembull, ne si kuvendarë as që e kemi idenë sa departamente, sa seksione do t'i ketë Agjencia, pastaj kush do të udhëheqë me këto seksione si dhe çfarë kriteresh duhet të plotësojë kandidati për t'u zgjedhur apo emëruar në pozitën e kryeshefit ekzekutiv?

Pra, ne do t'i aprovojmë dispozita me të cilat rregullohen çështje periferike, siç janë: qëllimi i ligjit, përkufizimet, statusi i Agjencisë, misioni, simbolet, nxjerrja e akteve nënligjore si dhe hyrja në fuqi e këtij ligji, kurse Qeverisë do t'i mbetet t'i rregullojë çështjet substanciale që kanë të bëjnë me Agjencinë.

Jam i mendimit se një zgjidhje apo rregullim i këtillë i dy çështjeve tejet të rëndësishme të Agjencisë dhe atë struktura organizative dhe kryeshefi ekzekutiv i saj, e bëjnë këtë draftligj tejet jofunksional dhe vështirë të zbatueshëm. Andaj, kërkoj që në shqyrtimin e mëtutjeshëm, komisionet përkatëse të Kuvendi të fokusohen në evitimin e këtyre të metave esenciale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra,

Kolegë deputetë, të nderuar,

Projektligji për themelimin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale nuk mund të themi në kuptim të plotë të fjalës që është i mirëpritur për faktin se nëse e kemi parasysh edhe deklaratën e ministrit të Financave se ka implikime buxhetore dhe vjen në një kohë kur kemi shumë prioritete si institucione dhe si shtet përballë këtyre dukurive tjera.

Ne jemi të gjithë dëshmitarë se pas luftës kemi pasur një trend të ndërtimit të pakontrolluar të komplekseve memoriale, do të thotë, kemi pasur një dobësi sa i përket këtyre komplekseve memoriale, duke menduar se përmes memorialëve nderojmë të vdekurit tanë - atyre që e dhanë jetën për Kosovën dhe ne të gjithë e dimë se memoriali nuk i nderon ata. Nderi i tyre është më së shumti duke ndjekur rrugën e tyre. Jo sot nuk jemi në kohë të luftës që të luftojmë, por të ndjekim në mënyrë paqësore ata për çka edhe e janë jetën dhe nder më i madh për ta është nëse kujdesemi për familjet e tyre, ngase e dimë që familjet e shumë dëshmorëve jetojnë në kushte të rënda ekonomike dhe ne duhet të përkujdesemi për ta. Dhe, ky është përkujdesi më i madh ndaj atyre që dhanë jetën për Kosovën dhe jo memorialet.

Ndërsa, themelimi i kësaj agjencie për menaxhimin e këtyre komplekseve vjen do të thotë mbi një themel jo të shëndoshë, ashtu sikur që e përmendi edhe deputeti më herët, e kemi një kaotizëm sa i përket ndërtimit të këtyre komplekseve dhe pikërisht kjo agjenci themelohet në bazën e një kaotizmi, do të thotë si pasojë e një gabimi, jo mirë të menaxhuar ndërtohet tash edhe kjo agjenci i cili është një gabim tjetër në veti.

Ne kemi shumë prioritete si institucione. Të marrim parasysh faktin që ne këtu në Parlament kemi kthyer prapa Ligjin për veteranë dhe invalidë të luftës, që janë kategori që kanë dhënë pjesët më të shtrenjta të trupit të tyre për lirinë tonë, i kemi pensionistët, i kemi shumë familje në shkallë të rëndë sociale, ndërsa sot duhet të merremi me diçka që është më sekondare përballë këtyre fakteve, do të thotë të miratojmë një ligj, i cili gjithashtu nuk e ka pasur përkrahjen e ministrit të Financave dhe kërkon implikime buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,
Të nderuara deputete dhe të nderuar deputetë,
Unë nuk do të fokusohem në formën e projektligjit, por do të përpiqem të them pak fjalë për përmbajtjen e tij.

Në qoftë se e bëjmë një përshkrim figurativ, do të thoshim se ky projektligj përshkruan, koncepton figurativisht do të thosha shenjat e shenjta të gjeografisë së vendit tonë. Në qoftë se e shikojmë kështu, natyrisht se çdo meditim do ta grishë përmbajtja e tij dhe jo forma.

Unë për veten time, sikur edhe shumë deputetë këtu, kemi qenë të pakënaqur me trajtimin që u është bërë këtyre shenjave të shenjta deri tani.

Është fat i mirë që Qeveria e ka sjell këtë projektligj këtu në këtë seancë dhe do të marrë miratimin absolut, patjetër dhe në të ardhmen do të gëzojnë: përkrahjen, mbështetjen, përkujdesjen dhe duke analizuar ndonjë nga këto paraqitje që i pamë sot, më lindi ideja që të bëj një propozim që dimensionet e këtyre memorialëve të rriten dhe mermeri i tyre të shkëlqejë sa më shumë dhe të përzgjidhet sa më tepër në ekonominë e tregut.

Ne e kemi një vend që tani është bërë një nga vendet më të shenjta, që konsiderohet Mekë dhe Medinë, është Prekazi heroik i cili vizitohet nga miliona apo afër 10 milionë vizitorë ka pasur në këto vite, prej pasluftës e deri sot dhe që për vite të tëra bëhen ndërhyrje aty, po nuk kompletohet tërësisht, për shkak të vështirësive që i njohim të gjithë.

Është momenti që përmes këtyre veprimeve institucionale të rritet përkujdesja ndaj këtyre shenjave të shenjta të vendit tonë dhe duke u përkujdesur për to do të forcohet kujtesa jonë për të kaluarën tonë dhe do të rritet respekti për të kaluarën dhe për të ardhmen tonë.

Natyrisht se edhe ne do të ndryshojmë ndaj atyre shenjave të shenjta dhe do të ndryshojmë edhe me vetveten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Fjala ime është një reagim që u bë pak më herët ndaj fjalës së zonjës Lama. Me keqardhje e them, nënkryetar, të keqpërdoret foltorja në Kuvend dhe të thuhet gjëra që nuk duhet t'i thotë një qytetar i thjeshtë i qytetit të Gjakovës, e para se gjithash një deputete, të flasësh me këtë gjuhë për një dëshmor të kombit, për Agron Ramën, me të vërtetë për mua është e papranueshme. Të flitet për një gjë të pavërtetë, është më shumë se e papranueshme. Ndërtimi i një përmendoreje në sheshin në komunën e Gjakovës, është vendim i Kuvendit të Gjakovës, para se gjithash është vullnet edhe i kryetarit të komunës së Gjakovës, është vullnet i shumicës së padiskutueshme të qytetarëve të komunës së Gjakovës.

Zonja Lama flet për një numër shumë të vogël të qytetarëve të vet. Ngritja e përmendores së dëshmorit të kombit, zotit Agron Rama, në komunën e Gjakovës i bën nderë komunës së Gjakovës, e ka zbukuruar edhe më tepër komunën e Gjakovës dhe unë kisha dashur që

këtu të flitet sikurse u fol edhe nga disa deputetë, që të kenë përkujdesje më të madhe, pikërisht këto përmendore, këto memoriale e jo të flitet me këtë gjuhë.

Prandaj, mua më vjen keq të dëgjohet një zë i tillë dhe unë nuk di më tepër të them, vetëm se duhet të punohet shumë më shumë në këtë drejtim dhe dëshmorët nuk janë ata që parcializohen, nuk kanë rënë për një fshat apo një qytet, por kanë ra për të na mbrojtur dhe për këtë ditë që neve sot jemi në Kuvend. Prandaj, për mua, edhe një herë, me keqardhje e them, pse ndodhem mu në këtë mes dhe dëgjoj këtë fjalor.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, zonja Lama, a doni replikë?

SEVDIJE LAMA: Kryesues,

Mua më vjen shumë keq pse duhet ta marr fjalën. Jemi duke debatuar për Ligjin. Nuk është kjo pika për deklarime jashtë rendit të ditës. Por, meqenëse ia dha fjalën deputetes në fjalë, atëherë më duhet të reagoj.

Zonja Teuta, nuk e pata fjalën pikërisht për dëshmorin Agron Rama, por fola në përgjithësi për kaosin, e pikërisht rast konkret është edhe Gjakova. Edhe është shumë e vërtetë që qytetarët atje kanë reaguar. E thashë, me themelimin e kësaj agjencie, shpresojmë të rregullohet dhe kjo çështje të bjerë në binarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro Teuta, veç shkurt, se keni dalë pak prej teme.

TEUTA HAXHIU: Shumë shkurt nënkryetar,

Sa është folur për atë ekziston transkripti. Unë po them që foli konkretisht për këtë, edhe një herë po e them, po më vjen keq, prandaj duhet ta tërheqë fjalën. Të ju kërkojë falje, para së gjithash, të gjithë qytetarëve të komunës së Gjakovës.

KRYESUESI: Dy deputete shumë të nderuara dhe deputetë të nderuar të Kuvendit, Ju lutem, kjo bisedë u ndërpre. Edhe e para, kur shkruhet emri më askush nuk e ka në kllapa këtu “e kam ndërmend të flas kështu, ashtu”. Kush paraqitet e merr fjalën, e çka flet e mban përgjegjësinë e vet. Prandaj, nuk e kam ndërmend të jap unë përgjegjësi kush derivon prej temës themelore. U krye kjo punë. Tash po kanë qejf të flasin edhe dy veta. Janë Hydajet Hyseni edhe Myzejene Selmani. A janë të fundit këta, apo ka edhe të tjerë? Sepse unë me qëllim, për ta bërë secilin më të disiplinuar, jua lexova emrat me rend. Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Nënkyetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra, zëvendëskryeministër,

Ju përshëndes dhe e mirëpres sjelljen në Kuvend të ligjit që po e shqyrtojmë.

E konsideroj të rëndësishme edhe rregullimin me ligj të kësaj materieje, që nuk e përjashton atë që u tha këtu, se duhet të shoqërohet edhe me kujdes ndaj familjeve, e gjithçka që lidhet me komplekset memoriale. Por, kujdesi ndaj të gjallëve, megjithatë,

nuk e përjashton edhe nderimin e së kaluarës, të kujtesës. Shumëçka sot nuk do të ishte po të mos ishte e kaluara dhe kujtesa për ta.

Megjithatë, dua t'i theksoj 2-3 vërejtje, të cilat prita që do të theksohen dhe mendoj se duhet të kihet parasysh në procesin e mëtejshëm të amendamentimit.

Së pari, po konfundohen nganjëherë komplekset memoriale që janë dhe duhet të kujdesemi për to dhe ato që eventualisht mund të bëhen më vonë. Dhe, kjo e shtron çështjen se a thua është zgjidhja më e mirë gjithmonë ajo të cilën e kemi gjetur ne si model - agjencitë, agjencitë. Ka një inflacion agjencish dhe gjithnjë më duket se janë vështirë të menaxhueshme vetë agjencitë që duhet ta menaxhojnë një fushë, vështirë të kontrollueshme në mënyrë demokratike e ligjore.

Aq më tepër kur këto agjenci shpesh nuk vendosen në vendin e duhur. Për shembull, për mendimin tim, prirja për të vendosur gjithçka që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, në Ministrinë për Planifikim Hapësinor më del jo adekuate, thënë më së buti. Ministria për Planifikim Hapësinor e ka rolin e vetë fillestar në vendosjen e tyre. Por, vendosja e tyre ekskluzivisht nën mbikëqyrjen e Ministrisë për Planifikimin Hapësinor më duket se e hendikepon shumë Ministrinë për Kulturë, prandaj mendoj që aty e ka vendin menaxhimi dhe kujdesi edhe për komplekset memoriale, edhe për trashëgiminë kulturore.

Dua të theksoj se gjatë amendamentimit duhet të kemi kujdes edhe në qasjen inkluzive, gjithëpërfshirëse, jo selektive për komplekset memoriale, sepse e kemi prirjen e një qasjeje selektive dhe shpesh diskriminuese.

Dhe, ajo që dua të theksoj për fund, e që jemi të obliguar ta respektojmë, sepse edhe Kushtetuta e thotë, trashëgimia fetare dhe kulturore në Kosovë mbrohet siç është nënvizuar tekstualisht në Kushtetutë dhe kështu ka qenë edhe në dokumentin e Ahtisarit. Po e them ka qenë, sepse s'është më obliguese si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Mendoj që është një postulat që duhet të kihet parasysh në gjithë qasjen, sepse çdo qasje tjetër e bartjes jashtë Kosovës është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me aktet tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit e paraqitur është zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritet për tre ministrat dhe deputetët,

E përkrah Ministrinë për ardhjen e këtij projektligji në Kuvend për arsye se të gjithë deputetët dhe të gjithë qytetarët duhet të kemi njohuri se dëshmorët janë dëshmorët të Kosovës, e nuk janë dëshmorë të një komune, ose të një subjekti politik. Dhe, në rast se aludojmë të përmendim emra dhe t'i ndajmë në dëshmorët e kësaj komune dhe dëshmorët e këtij kompleksi memorial të kësaj komune apo të asaj komune, mund të ju them shumë sinqerisht se po ia bëni dëmin më të madh kësaj Kosove. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Para se ta hedh në votim, unë e kam një gjysmë fjale, mandej ia jap fjalën, nëse e do, përfaqësuesit të Qeverisë.

Unë i pashë dy mënyra të leximit. Ky nuk është ligj për ndërtim memorialesh, por ligj për krijimin e një agjencie për menaxhimin, dikur i kanë thënë për drejtimin ose udhëheqjen. Kështu që janë dy gjëra krejt të ndryshme, as s'ka të bëjë se a janë estetike këto që janë ndërtuar, as s'do të jenë estetike të tjerat, ato janë krejt punë tjera. Pra, kjo është e qartë. Në këtë kuptim, le të më lejohet t'i referohem diskutimit shumë precizë të deputetit Demolli, të cilin e mbështes, dhe mendoj që një ligj i tillë për një agjenci nuk ka kurrfarë arsye të plotësohet me akte nënligjore të Qeverisë, kur ka mundësi shumë mirë që dy çështje që i theksoi ai, strukturën organizative dhe mënyrën e zgjedhjes së stafit ekzekutiv, të bëhen ligj, dhe unë trimëroj deputetin Demolli që idetë e tij shumë të sakta t'i bëjë amendamente për leximin e dytë. Kaq.

Atëherë, përfaqësuesi i Qeverisë, nëse e do fjalën, është e drejta e tij. Urdhëro!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që ne kemi pritur që do të ketë debat edhe emocional rreth kësaj teme dhe është e vërtetë që nuk është paraparë në kornizën afatmesme buxhetore, sepse ideja për themelimin e kësaj agjencie ka ardhur, ndër të tjera, duke pasur parasysh edhe përvojën që ne e kemi në ministri për afërsisht këto dy vjet që unë e udhëheq. E në vit për afërsisht shpenzime afro 4 milionë euro, kurse për të gjitha këto projekte, pas përfundimit, nuk është përcaktuar se kush menaxhon me to më tutje. Ne marrim llogari për shpenzimet e rrymës, marrim llogari për lloj-lloj shpenzimesh, të cilat nuk janë të adresuara aty ku duhet dhe për shumë arsye të tjera.

Sa i përket edhe asaj që u fol këtu për aspektin politik, kisha dashur edhe një herë të them se pikërisht edhe kjo tentohet të mënjanohet, politizimi pra pikërisht i kësaj fushe. Ne gjatë këtyre dy vjetëve kemi qenë shumë të balancuar në atë se kush dhe ku është ndërtuar çfarë memoriali, mirëpo kjo nuk duhet të mbetet në të ardhmen në duart e një ministri ose një ministrie që të vendosë se çka do ndërtohet dhe kush do të nderohet vitet e ardhshme. Dhe, për këtë arsye ka ardhur ky propozim.

Unë ju siguroj se do të bashkëpunojmë maksimalisht në punën e Komisionit, që të gjitha këto vërejtje që sot erdhën, shumica e tyre vërejtje të qëlluara, do të merren parasysh. Ne si ministri jemi të interesuar që kjo çështje të zgjidhet ose kjo agjenci të vendoset në kuadër të Ministrisë. Unë mendoj se nuk e ka vendin, pajtohem me deputetin Hyseni. Ose të kalojë në një ministri tjetër, ose ndoshta si është më së miri të kalojë në përgjegjësinë e këtij Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: I kryem të gjitha diskutimet rreth këtij projektligji. Ju lutem, bëhuni gati për ta votuar në parim këtë projektligj, pra Projektligjin për agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës.

Në sallë i kemi të pranishëm 69 deputetë dhe votojmë tash!

Projektligji kalon në parim me 64 vota për dhe me një abstenim.

Të nderuar deputetë,

Të merremi vesh edhe praktikisht, edhe institucionalisht. Ne e kemi edhe një ligj në lexim të parë dhe i kemi 3 ligje në lexim të dytë, që kanë shumë pak nene. Unë kërkoj nga ju që nëse jeni të pajtimit që t'i kryejmë këto para dreke, shans kemi, vendosni ju vetë. E kemi një lexim të parë dhe kemi 3 ligje, po njëri s'e ka asnjë nen. Vendosni ju!

Tash kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me rregullore tjera ta shqyrtojë projektligjin dhe t'ia sjellë Kuvendit raportet.

Kalojmë në pikën e gjashtë:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandimet për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj. Urdhëro, ministër!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj do të sigurohet mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, shfrytëzimi i egër dhe keqpërdorimi dhe të përcaktohet korniza institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Në programin legjislativ për vitin 2012, Projektligji për ujërat e Kosovës është paraparë edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.

Projektligji përbëhet prej 15 krerëve dhe 114 neneve.

Konsultimet paraprake dhe publike janë bërë në pajtim me nenin 7 dhe 32 të Rregullores për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës dhe ligjet që janë të përafërta me dispozitat e Bashkimit Evropian. Ju falënderoj për përkrahje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Në emër të Komisionit FunkSIONAL nuk kam të paraqitur. Do të kemi tash deklarimet e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti zoti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji i deritashëm për ujërat e Kosovës nuk e mbulon në tërësi lëmin e administrimit të resurseve ujore dhe aty nuk janë të përfshira detyrimet që dalin nga direktiva e Bashkimit Evropian 2000/60.

Vëllimi i ujërave të Kosovës është i kufizuar, siç jeni në dijeni, dhe përmbushja e këtyre kërkesave për konsum është jashtëzakonisht e madhe. Ne obligohemi që këtë sasi të ujërave të mundësojmë të shfrytëzohet për qëllime shumë qëllimore.

Kosova ka probleme serioze, jo vetëm për shfrytëzimin e qëndrueshëm të sasisë së ujërave, por ka shumë probleme me cilësinë e tyre, sepse nuk kemi trajtim as minimal të ujërave të ndotura dhe për pasojë ato po përfundojnë në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke rrezikuar shëndetin e rreth 40% të popullsisë që furnizohet me ujë nga pusët.

Kosova ka pak plane të hartuara mbi ujërat, madje disa nga ato edhe janë të skaduara.

Ne e kemi mungesën e kadastrës së plotë të ujërave, i cili e bën këtë sektor me hendikep dhe zbatimin e këtij ligji e bën të hendikepuar.

Po ashtu, e kemi edhe strategjinë e ujërave, e cila në fakt është duke u hartuar. Ne shpresojmë që me kompletimin e kësaj baze ligjore të këtij dokumentacioni, ky ligj të bëhet i zbatueshëm dhe do të jetë afatgjatë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim këtë Projektligj dhe do ta votojmë dhe do të punojmë në fazat e ardhshme për pasurimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e LDK-së, fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj, i cili ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e ujërave, mbrojtjen e veprimeve të dëmshme të ujit, duke përfshirë përmytjet, vërshimet, erozioni. Mirëpo, shqetësuese sikur edhe në projektligjet tjera që deri më tani i ka sjellë Qeveria, edhe projektligji i mëparshëm, kryesisht nga Ministria e Mjedisit, si shqetësim edhe ky projektligj ka të bëjë me deklaratën financiare, të cilën e ka paraqitur MEF-i, që parasheh se ky projektligj nuk mund të jetë i implementueshëm për shkak se e ka një kosto të lartë buxhetore dhe kryesisht e ka paraqitur në nenin 15, ku kemi të bëjmë me formimin e Këshillit Kosovar për Ujëra, pastaj formimin e Institutit Kosovar për Ujëra, neni 21, pastaj autoriteti i rajoneve dhe pellgjeve lumore, neni 22, dhe disa nene tjera.

Do të thotë është shqetësim për ne fakti se këto projektligje nuk janë të përfshira në KASH-in e vitit 2013-2015 dhe në kornizën buxhetore të vitit 2013 dhe 2015. Dhe njëkohësisht është në kundërshtim direkt me Rregulloren e Kuvendit, sepse thuhet decidivisht që çdo projektligj, i cili sillet në parlament duhet ta ketë koston e mjaftueshme buxhetore.

Ndërsa, nga disa ministri dhe nga Qeveria kemi shumë projektligje, të cilat po sillen në Parlament, po miratohen, po aprovohen, e po janë të paimplementueshme. Andaj, ky është një shqetësim i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, sepse nuk është fjala vetëm për këtë projektligj, por kemi shumë ligje të miratuara, të cilat po mbeten nëpër sirtarë dhe njëkohësisht nuk janë të implementueshme për shkak se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për implementimin e tyre. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar Projektligjin për ujërat do ta votojmë atë, meqenëse ka elemente pozitive në të. Natyrisht i kemi edhe vërejtjet tona. Një ndër elementet e para pozitive është fakti që definohet pronësia e ujërave, gjë që nuk ka qenë e definuar deri tash, si pronësi e shtetit të Republikës së Kosovës. Ndërsa çështjet që do të duhej të sqaroheshin më tepër dhe të intervenohej në këtë ligj është së pari qartësimi i kompetencave të Komunës, respektivisht qartësimi i marrëdhënies së inspektorit në nivel të Komunës në raport me inspektorin në nivel qendror, e po ashtu duhet të qartësohen edhe raportet e njësisë së pellgut me Komunën.

Për sa i përket çështjes së njësive rajonale të pellgjeve, një gjë e tillë ka qenë kërkesë edhe e Bashkimit Evropian dhe e kemi në Raportin e Progresit, por ka qenë po ashtu edhe me ligjin e kaluar, e nuk është zbatuar deri më tash, tash e sa vite, por shpresojmë që do të bëhet tash.

Sa i përket autoritetit të pellgjeve, thuhet që do të jetë nën Departamentin e Ujërave në kuadër të Ministrisë, ndërsa, në anën tjetër, në nenin 51 -monitorimi i plotave, thuhet: “Në rast të fenomeneve dhe dukurive ujore të paralajmërohet ministri në afat prej gjysmë ore deri një orë”. Nëse definohet me ligj komunikimi i drejtpërdrejtë me ministrin, por një gjë e tillë bëhet nëpërmjet departamentit, atëherë raportimi i tillë drejtpërdrejt i ministrit brenda gjysmë ore deri në një orë është në fakt i paqartë.

Po ashtu, duhet të definohet saktë se në shumë çështje, për shembull përmenden rrëke, përmenden çështje kur kemi dëme nëpër shtretër të lumenjve, e kështu me radhë, thuhet që këto do të ngelin në përgjegjësi të nivelit rajonal të pellgut dhe Komunës. Rregullimi i tyre - duhet të definohet kush saktë e mban përgjegjësinë. Përgjegjësia e saktë, meqenëse niveli rajonal është mbi Komunën, a do të jetë përgjegjëse dhe kush e organizon një gjë të tillë, kush e udhëheq organizimin? Mund t’i ndihmojë Komuna, apo komuna e merr nismën për ndonjë dëm në erozion, apo shkatërrim të vijës së ujit, e kështu me radhë? Cili është ai i cili e merr saktë përgjegjësinë dhe ky definim i përgjegjësisë nuk mund të lihet

thjesht që Njësia Rajonale e Pellgut dhe Komuna bashkë e bëjnë këtë punë, por duhet të definohet.

Sa i përket Këshillit të Ujërave, në anën tjetër është edhe Instituti, pra parashihet një institut i ujërave, parashihet këshilli i ujërave, që do të jetë në nivel të Qeverisë, e po ashtu edhe autoritetet e pellgeve. Duhet të definohen qartë vijat vertikale, pastaj kompetencat e qarta, si dhe duhet të sigurohemi që kemi mjaft staf dhe ekspertë që edhe Këshillin e Ujërave, që do të jetë ndërministror, ta plotësojmë me ekspertë të lëmit, e po ashtu edhe institutin, sepse unë nuk e di që kemi numër të mjaftueshëm të ekspertëve që të ndërtojmë kaq shumë nivele, të cilat do të bëjnë analiza e shqyrtime të shumta, e në anën tjetër na mungon numri i mjaftueshëm i ekspertëve.

Këto janë pak a shumë vërejtjet. Pra, çështja te Inspektorati i Komunës duhet të definohet qartë se kush e zgjedh inspektorin komunal. Në një rast lihet të mendohet te mbikëqyrja inspektuese që në rast kur vendos inspektori ta shkarkojë atë të nivelit komunal, atëherë i dërgon kryetarit dhe Komunës letër të shkruar, gjë që krijon përshtypjen se kjo po u zgjidhka nëpërmjet tij, por në ligj përgjithësisht përzgjedhja e inspektorit në nivel komune nuk përcaktohet se kush e bën, kush e emëron dhe kujt i raporton ai inspektor në nivelin komunal. Nëse ky është autoritet qendror që e zgjedh deri në Komunë, po e zgjedh ministria apo inspektorati qendror, atëherë një gjë e tillë të definohet qartë. Nëse inspektori komunal zgjidhet nga kryetari i Komunës, duhet të definohet qartë kujt i raporton; a i raporton një herë kryetarit dhe cila është marrëdhënia ndërmjet kryetarit të këtij inspektori të nivelit qendror dhe atij komunal. Janë çështje të cilat mendoj se duhet të sqarohen.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj, i cili është i një rëndësie të veçantë. Ka ekzistuar një ligj që e ka rregulluar çështjen e ujërave në Kosovë, mirëpo nuk ka qenë i tërë dhe përmbajtësor.

Ky projektligj është në Raportin e Progresit. Qëllimi i projektligjit ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social ekonomik të Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës do ta përkrahë në parim dhe do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është për t'u përshëndetur procedimi i këtij projektligji nga Ministria për Planifikim Hapësinor, duke pasur parasysh faktin që uji është burim kryesor për jetën e njeriut, pra së pari për shëndetin, pastaj për mirëqenien e tij higjieno-sanitare, për zhvillimin e bujqësisë dhe të ekonomisë, në përgjithësi.

Ne jemi dëshmitarë që në këto vite janë bërë mjaft keqpërdorime sa i përket menaxhimit të ujit, mund të themi edhe abuzime, duke pasur parasysh faktin sidomos në kohën e thatësisë, në kohën e verës, kur një pjesë e mirë e qytetarëve, pa dallim komune këtu, kanë pasur probleme, më mirë të them reduktime të ujit, ndërsa pjesa tjetër e ka shfrytëzuar ujin edhe për çështje më sekondare sa u përket çështjeve vitale, duke pasur parasysh shfrytëzimin e ujit për pishina, restorante apo rekreacione të ndryshme, e fakti tjetër qytetarët janë ballafaquar me reduktime të mëdha.

Andaj, këtu duhet pasur mjaft mirë parasysh menaxhimin në situata të tilla të thatësisë së verës për ujin e pijshëm.

Gjithashtu, vlen të përmendet edhe një çështje, e ndoshta këtu Komisioni ka punë për të bërë, kur në vendet publike ku gjenden pikat e ujit të pijshëm, burimet e ndryshme, të bëhen kontrole të vazhdueshme nga inspektorët dhe institutet biokimike dhe mikrobiologjike dhe aty të vendoset së paku çdo një muaj tabela që tregon se uji është i pijshëm apo se nuk është i pijshëm, për faktin se aty frekuenton një numër i madh të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë nuk do të isha ndalur më tepër në projektligj, pasi punën kryesore e ka Komisioni, por vërejtjet e mia janë vetëm në nenin 60, paragrafi 1, ku ceket se me qëllim të mbrojtjes së përmirësimit të cilësisë së ujërave, trupat e ujërave nëntokësorë duhet të klasifikohen në klasa, në pajtim me gjendjen sasiore dhe kimike është këtu. Theksoj se duhet të jetë - gjendja sasiore dhe biokimike dhe mikrobiologjike, pasi faktori mikrobiologjik është faktor relevant që e definon ujin a mund të jetë i pijshëm apo jo, ngase një faktor i tillë mund të shkaktojë edhe epidemi nëpër masa të mëdha endemike.

Dhe, neni tjetër është neni 65, paragrafi 2, ku thuhet - personat juridikë dhe fizikë të cilët shkaktojnë pasoja me veprimet e tyre janë të detyruar me shpenzimet e veta t'i kompensojnë dëmet e bëra personave tjerë dhe resurseve ujore. Është e vërtetë që nëse një person, qoftë fizik apo juridik, shkakton me veprimin e tij pasoja në njerëz, atëherë nëse ato janë pasoja materiale, normalisht që kompensimi duhet të jetë material. Po çka nëse pasojat janë njerëzore dhe shëndetësore, atëherë nuk ka kompensim material i cili mund t'i kompensojë këto pasoja.

Ne si Grup Parlamentar do ta përkrahim këtë projektligj, ndërsa puna kryesore mbetet në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit "6+", fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna Grupa „6+“ je pažljivo analizirala Nacrt zakona o vodama Kosova. Ova oblast je obuhvaćena akvisom ono što je stečeno. Voda je jedan od najvažniji sveobuhvatnih regulisani oblast u zakonodavstvu Kosova o životnoj sredini.

Odredbe ovog Nacrta zakona Kosovskih vodama sadrži akvisom koji pokriva sektor voda.

U principu, Nacrt zakona je dobro regulisan.

Parlamentarna Grupa „6+“ podržava ovaj Nacrt zakona i svoj doprinos daćemo kroz rad Komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit që e merr fjalën është deputeti Lutfi Zharku, dhe i thërras deputetët të hyjnë brenda, sepse do të votojmë edhe për lexim të dytë, edhe këtë ligj.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Kolegë deputetë, ministra,

Dy çështje: E para ka të bëjë me krijimin e shumë institucioneve që kanë të bëjnë me rregullimin e ujërave. Unë po i përmend, sipas ligjit, janë 6 institucione që duhet të krijohen, apo disa prej tyre ndoshta edhe funksionojnë.

I pari është Këshilli i Kosovës për Ujëra, e kemi Këshillin Ndërmintor për Ujëra, e kemi Institutin për Ujëra, Departamentin për Ujëra, pastaj Autoriteti i Rajonit të Pellgut Lumorë dhe Njësia e Rajonit të Pellgut Lumor.

Unë thjesht nuk besoj që të gjitha këto institucione që krijohen mund të koordinohen dhe të punojnë si duhet në praktikë. Sa më i madh zinxhiri, aq më shumë zbrazëtira juridike, aq më shumë probleme dhe aq më shumë punë për koordinim. Kështu që një pjesë e tyre besoj që janë të panevojshme apo duhet të bashkohen. Po e marrim, për shembull, Këshillin Profesional për Ujëra, nuk shkruan që është profesional, por po besoj që është profesional. Nëse themelohet edhe Instituti për Ujëra, Këshilli Profesional mund të jetë në kuadër të tij.

Në anën tjetër, Këshillin Ndërmintor për Ujëra e kuptoj vetëm si një organ, apo trup që e formon, por që në realitet nuk mund të menaxhojë për shkak se përgjegjësia duhet të jetë prapë e ministrisë, e cila është kompetente, në këtë rast Ministria e Mjedisit.

Çështja e dytë ka të bëjë me strategjinë. Po e shoh që strategjia, sikur edhe disa strategji tjera, duhet të aprovohet në Kuvend. Mendimi im personal është: ne kemi pasur problem me disa strategji, të cilat kanë ardhur prej Qeverisë. Në Kuvend janë ndryshuar, kështu që shpesh vjen deri te një kundërthënie ndërmjet strategjisë që vjen prej Qeverisë dhe strategjisë që aprovohet në Kuvend, e cila plotësohet. Kështu që mendimi im personal është në strategjitë duhet të jenë vetë të Qeverisë, natyrisht që Kuvendi duhet të informohet për ato strategji, por strategjia duhet të jetë e lirë, që Qeveria ta implementojë

sipas vizionit të vet dhe Kuvendi natyrisht ta ketë rolin mbikëqyrës në zbatimin e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. I thërras ata që janë skajeve të hyjnë brenda se tani do të votojmë. Tash në sallë i kemi 61 deputetë.

Ju lutem, të bëheni gati për miratimin në parim të Projektligjit për ujërat e Kosovës. Votojmë tash!

Konstatohet se me 58 vota për, asnjë abstenim dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë këtë Projektligj, ta amendamentojnë dhe t'ia paraqesin raportet Kuvendit në lexim të dytë.

Tërheq vëmendjen se këtu, kur bisedohet për herën e parë, bisedohet veç parimisht. Parimisht, joparimisht, leximi i parë faktikisht te ne e aprovon ligjin. Nëse këto diskutime nuk bëhen amendamente janë të mira për letër joproduktive.

Shkojmë tutje, pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, duke konstatuar se nuk ka arsye për amendamentimin e neneve të këtij projektligji. Shkurt, i bie që nuk ka asnjë amendament. Nëse e do fjalën kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Arben Gashi. Shkurt!

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni e ka trajtuar dhe ka vlerësuar se nuk ka nevojë për amendamente, prandaj i rekomandon seancës që ta përfundojë këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, bëhuni gati që ta votojmë tekstin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-006 për procedurën kontestimore, në formën e propozuar nga Qeveria. Pra, s'ka amendamente. Votojmë tash!

Në sallë i kemi të pranishëm 67 deputetë,

Konstatohet se me 66 për, asnjë abstenim, as votë kundër, Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-006 për procedurën kontestimore.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për bujqësinë organike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni FunkSIONAL nuk e ka kërkuar fjalën.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej tri amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës siç janë paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 3.

Kolegë të nderuar, tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, bashkë me tri amendamentet që i aprovuam tash. Lus regjinë dhe deputetët të votojnë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 68 vota për, asnjë abstenim dhe asnjë votë kundër, Kuvendi e miratoi Projektligjin për bujqësinë organike.

Kalojmë në pikën e nëntë dhe të fundit të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillim rural dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Nuk shoh që e kërkon fjalën dikush nga Komisioni FunkSIONAL.

Atëherë në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 11 amendamente, që janë të Komisionit FunkSIONAL.

Ju lutem, do të votojmë për këto amendamente.

Amendamenti 1

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

A ka kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Kundër, nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet amendamenti 11.

Tash do ta votojmë këtë projektligj në tërësi, bashkë me 11 amendamentet që sapo i votuam, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votimin e fundit komplet. Votojmë tash!

Konstatohet se me 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Seanca mbaroi, e vazhdojmë tjetrën të hënën. Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë